

## MBI 2 MILIARD LEKË INVESTIME NË INFRASTRUKTURËN RRUGORE

**-Intervistë me drejtorin e DRRR Lezhë, z. Valentin Ndoja**




Drejtorin e Drejtorisë Rajonale të Rrugëve në Qarkun e Lezhës, z. Valentin Ndoja, e gjetëm tek po shfletonte në zyrën e tij projektet e asfaltimit të rrugëve në tre rrethet e këtij qarku: Lezhë, Kurbin e Mirditë. I qeshur, komunikues, korrekt në punë dhe i përkushtuar për të bërë realitet objektivat që i ka vënë vetes, ai thotë se puna e deritanishme ka qenë e sukseshme në qeverisjen demokratike,

sidomos në asfaltimin e rrugëve, ku deri tani janë investuar nga fondet e Qeverisë mbi 2 miliard lekë, punë e cila do të vazhdojë edhe në të ardhmen me prioritet në funksion të zhvillimit të turizmit

faqe2-3

## LEK SHTIA

### NJË BURRË NË VETULL TË TRANGËS



Mark Blach në librin e tij "Mjeshtëria e historianit," shprehet: "...e kaluara është një e dhënë të cilën s'mund ta ndryshojë asgjë..". Kjo sentencë më ka motivuar ta shikoj librin e ri të autorit Gjet Doda "Preng Gjok Deda –monografi-", jo vetëm në këndvështrimin letrar, që pa dyshim ka vlera artistike, por më së shumti në cilësinë studimore. Është një prurje e vlefshme në etnografi, histori dhe lëvizje politike të ndodhura kryesisht në Mirditë,

faqe 12

## VËZHGIM

### KUR PUNON PËR TË TREMBUR TURISTËT

Është për të ardhur keq kur shikon se si, një nga plazhet më të bukura të Shqipërisë dhe pothuajse të të gjithë Ballkanit, siç është Shëngjini, degradohet gradualisht në një kohë që qeveria shqiptare ka akorduar mjaft fonde për ta bërë sa më atraktiv këtë qendër të rëndësishme të turizmit dhe zhvillimit të rajonit, duke filluar nga autostrada etj. Por si ndodh në të vërtetë realisht në Shëngjin? Asnjëherë nuk shikon se punohet në infrastrukturë gjatë periudhës së vjeshtës, dimrit a pranverës, por menjëherë, sapo fillon sezoni plazhit, fillon puna në infrastrukturë për ta bllokuar sa të jetë e mundur kalimin e makinave, që falë demokracisë dhe zhvillimeve që ajo solli në Shqipëri, vendi është mbushur me makina të llojeve të ndryshme. Pikërisht, në këtë periudhë kur duhet të ishte gjithçka gati, ejani dhe shikoni në Shëngjin se si kanë filluar punimet në mënyrën më skandalozë, duke bllokuar rrugët. Infrastruktura e bregut të detit është shumë e shkatërruar, por kësaj i shtohet edhe ndonjë grumbull zhavorri që hidhet pranë gropave dhe lihet ashtu nga punëtorët pa e hapur dhe sistemuar, si dhe kanalet ku fillohet të futen tubat e ujit të pijshëm. Ritmet e punës janë aq të shpejta sa që do të mbarojë sezoni i plazhit dhe ata do t'i keni ashtu gojëhapur deri në verën tjetër për të rifilluar odisea e turistëve në këto rrugë. Është vërtetë e paimagjinueshme se si njëherë nuk u bë e mundur në kaq e kaq vite që plazhi i Shëngjinit të jetë funksional në sezonin e plazhit. Deri kur do të shkojmë me këtë mendësi pa përfilluar kërkesat e kohës dhe nevojat e komunitetit. Gjithashtu është për t'u habitur që në plazh nuk ka të përcaktuar asnjë vendparkimi dhe në rrugët kryesore të hyrjes në plazh janë vënë trarët e pagesës së parkingut për të gjitha llojet e makinave. Vetë qytetarët janë shumë të ndërgjegjshëm që kjo lloj takse duhet të paguhet, por jo në këtë mënyrë, kur s'ka siguri parkingu, kur këto para nuk shihen të investohen në përmirësimin e infrastrukturës së plazhit etj. Këtë vit as përmbyssa e rërës nuk është bërë akoma deri në këto momente, nuk funksionon asnjë dush apo banjo publike për të cilët deklarohet në media se janë vendosur dhe janë funksionale. Ku duhet të japin llogari përgjegjësit e kësaj gjendjeje për këtë situatë? A mos vallë nuk duan që Shëngjini të jetë qendër e rëndësishme kombëtare e turizmit?

ALBAN RADA, PUSHUES

## ILUZIONI I MITIT DHE REALITETI HISTORIK

Ndoshta nuk do ta shkruaja fare këtë artikull sikur kundërshtimet ndaj librit "Skëndërbeu" të Oliver Jens Schmitt të mos ishin aq të shumta dhe të parapragjykuara, dhe mua të mos më pëlqente të qëndroja në iluzionin e neutralitetit. Sigurisht që studimi dhe trajtimi i figurave historike, sidomos atyre shumëplanëshe, është i vështirë dhe krijon ndjeshmëri të lartë.

faqe 11



## KOREOGRAFIA ËSHTË PJESË E JETËS SIME.



Koreografi i mirënjohur lezhian, Gazmend Golemi, vazhdon të përgatisë balerinët e ardhshëm, të cilet debutojnë me sukses në skenat e ndryshme, këtë fidanishte të së nesërme të tre moshave 5-16 vjeç, të pagëzuar me emrin "Eagle Dance",

faqe 4

## RRUGA ËSHTË ZHVILLIM DHE PËRPARIM I NJË VENDI

### -Shënime udhëtimi në rrugën e kombit Milot-Kukës

Rrugët janë zhvillim dhe përparim i një vendi, janë arteriet e një kombi, që bëjnë të mundur jo vetëm zhvillimin dhe përparimin ekonomik-social, por shtojnë lidhjet mes vendeve e popujve, shkurtojnë distancat dhe afrojnë njerëzit, qoftë vellezër të një gjaku, por edhe më gjerë, ato të rajonit, duke bërë të mundur jo vetëm qarkullimin e lirë të njerëzve, por edhe ato të mallrave, duke i dhënë



një hap cilësor zhvillimit ekonomik, sidomos të zonave rurale, të cilat ishin të izoluara dhe larg nga kryeqyteti, bregdeti apo me vellezrit e një gjaku, siç është Kosova. Këtë ka bërë të mundur rruga e kombit, rruga që bashkoi shqiptarët: Durrës-Kukës. Tek i afroresh urës së Matit, përpara të del lumi i Matit dhe më pas ai i Fanit, ku anës luginës se tyre, në të dy krahët, qëndrojnë madhështore malet e thepisura dhe të veshura me pyje, me bukuritë dhe resurset e shumta natyrore dhe mes tyre gjarpëron autostrada e gjerë sa një fushë, duke shkurtuar distancën e shmangur kthesat. Dikur nga Lezha për të shkuar në Kukës

është dashur 8 orë të mira me makinë, ndërsa sot këtë rrugë e përshkon për 2 orë. Natyrisht që kjo rrugë është vepra më e madhe e ndërtuar deri tani, një vepër që kur shikon se si janë çarë malet e larta e të thepisuara apo ndërtuar urat mbi lumenjtë Mat e Fan, të duket

diçka e pabesueshme se ku ka arritur mendja dhe forca e njeriut, me mjetet më moderne të kohës, sidomos kur të dalin



përpara dy tunelet e Thirrë- Kalimashit, një kryevepër me gjatësi 5.5 km secili, që kur kalon natën nën vezullimin e dritave dhe ndikimin ajrosës të ventilatorëve, kujton se ndodhesh në një qytet të nëndheshëm apo një "Semering" i dytë.

Korridor i kombit, rruga Durrës-Kukës, është vepra më e madhe e ndërtuar nga ky komb në historinë e tij, tuneli Thirrë-

Kalimash 5.5 km i gjatë, dy tunelet e radhazi, i cilësuar si ndër më të mëdhenjtë në Ballkan, ndërtuar nga firma amerikano-

turke Bechtel-Enka, e cila ka punuar në aksin më të vështirë atë Rrëshen-Kalimash 61km të gjatë, duke çarë malet e larta e të thepisura e duke hapur rrugën e gjerë 24 m, me katër korsi, ku automjetet shkojnë e vijnë si valë deti dy e nga dy sikur të ishe në një terren fushor e jo në grykën e maleve të larta, ku lartësia e një ure i kalon të 80 metrat, nga 29 të tilla të ndërtuara në këtë autostradë me përmasa evropiane, e cila e justifikon përmasën e investimit me rëndësi ekonomike, po aq sa edhe gjeopolitike një projekt gjigand e ndoshta i pabesueshëm për t'u realizuar nga skeptikët, por që sot është një realitet i gjallë e i prekshëm, që do të gjallërojë jetën e fshatrave të zonës së Rubikut, Rrëshenit, Repsit, Kalimashit, Kurbneshit,



Kukësit etj. dhe lëvizjen e lirë të vellezërve të një gjaku e qarkullimin e lirë të mallrave e zhvillimin e turizmit. Ndoshta vërteton thënien e një kolegut tim gazetar të asaj zone, publicistit të njohur Gjon Marku, i cili e përshkon shpesh këtë rrugë për arsye pune për në Kosovë, se kafën e mëngjezit e pi në Rrëshen, drekën e ha në Kukës dhe kafën e pasditës e pi në Prizren (tek po udhëtonim bashkë). Ky korridor i jep fund ndarjes në mes të kombit shqiptar, është vepra më e madhe e ndërtuar në Shqipëri në historinë e tij. Tani e tutje kjo zonë, nga Miloti deri në Kukës, do të lëvizë lirshëm dhe pa bezdi në këtë autostradë, ku detin, portin, kryeqytetin, kufirin do t'i ketë më afër, do të rrisë mirëqenien dhe prosperitetin dhe do t'i bashkohet denjësisht familjes së madhe evropiane që aspiron. Por sa herë ta përshkohësh këtë rrugë, dikur të lodhshme, sot argëtuese, mendja të thotë se jo vetëm për punë, por edhe për piknik, ta vizitosh këtë vepër të madhe në sherbim të njerëzve, qytetarë të denjë të këtij vendi dhe rritjes së mirëqenies së tyre.

## MBI 2 MILIARD LEKË INVESTIME NË INFRASTRUKTURËN RRUGORE

### -Intervistë me drejtorin e DRRR Lezhë, z. Valentin Ndoja



Drejtorin e Drejtorisë Rajonale të Rrugëve në Qarkun e Lezhës, z. Valentin Ndoja, e gjetëm tek po shfletoje në zyrën e tij projektet e asfaltimit të rrugëve në tre rrethet e këtij qarku: Lezhë, Kurbin e

Mirditë. I qeshur, komunikues, korrekt në punë dhe i përkushtuar për të bërë realitet objektivat që i ka vënë vetes, ai thotë se puna e deritanishme ka qenë e sukseshme në qeverisjen demokratike, sidomos në asfaltimin e rrugëve, ku deri tani janë investuar nga fondet e Qeverisë mbi 2 miliard lekë, punë e cila do të vazhdojë edhe në të ardhmen me prioritet në funksion të zhvillimit të turizmit me segmente rrugore gjatë bregdetit e bashkëpunimi i frutshëm me DPRR, me drejtorin z. Andi Toma e zv/drejtorin, z. Skënder Çato, që e kanë mbështetur me projektet për asfaltimin e rrugëve në këto rrethet e deputetët.

-Cila ka qenë gjeografia e segmenteve rrugore dhe investimet përkatëse?

-Drejtoria Rajonale e Rrugëve të Qarkut të Lezhës, si pjesë përbërëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve, ka realizuar

e tejkalar detyrat në kohë e cilësi në asfaltimin e rrugëve në tre rrethet e këtij Qarku: Lezhë, Kurbin e Mirditë, duke vënë në jetë objektivin e Qeverisë demokratike që zonat urbane e rurale të kenë infrastrukturen rrugore të asfaltuar sipas parametrave evropianë. Deri tani, nga investimet e Qeverisë shqiptare, janë akorduar mbi 2 miliardë lekë në asfaltimin e rrugëve të reja në tre rrethet, duke ndikuar ndjeshëm në lëvizjen e njerëzve dhe zhvillimin e këtyre zonave. Në rrethin e Lezhës janë kryer këto punime: sistemim-asfaltim rotonda Lezhë-Ishull-Lezhë, me vlerë 91 milion lekë, riveshje rruga Lezhë-Shëngjin me vlerë 5 milion lekë, riveshje rruga Lezhë-Hoteli i Gjetisë me vlerë 2.5 milion lekë, riveshje rruga Lezhë-Ura e Milotit me vlerë 5 milion lekë, riveshje rruga Balldre-Bisht Jukë me vlerë 3.8 milion

lekë, sistemim-asfaltim rruga Shëngjin-Kune me vlerë 3 milion lekë, sistemim-asfaltim Lezhë-Shëngjin me vlerë 270 milion lekë, sistemim-asfaltim Zejmen-Tale me vlerë 72 milion lekë, rikostruksion rotonda me vlerë 15 milion lekë. Në rrethin e Mirditës: rrëshitje në Gëziq me vlerë 49 milion lekë, rrëshqitje në Perlat me vlerë 29 milion lekë, gjërryerje Katund i Vjetër me vlerë 4.5 milion lekë, riparim vepra arti me vlerë 3.5 milion lekë, riparim Ura e Sheshit me vlerë 2.2 milion lekë, mure mbrojtëse Qafë-Benë me vlerë 6.6 milion lekë, riparim-asfaltim me vlerë 1.6 milion lekë. Në rrethin e Kurbinit: sistemim-asfaltim Laç-Kisha e Shën Ndout me vlerë miliard e 100 milion lekë, sistemim-asfaltim Laç-Supërstradë me vlerë 800 milion lekë, sistemim-asfaltim superstradë Laç-Gorre-Patok me vlerë 27 milion lekë etj.

-Cili është çelësi i suksesit në realizimin e këtyre investimeve?

-Së pari, është angazhimi total i stafit që unë drejtoj, i personelit inxhiniero-teknik dhe i punëtorëve, të cilët me punë të kualifikuar e përkushtim arrijnë të vënë në zbatim objektivat e vëna si drejtori në përbushjen e programit të qeverisë demokratike në politikë e suksesshme në fushën e infrastrukturës rrugore të bëra realitet dhe së dyti, bashkëpunimi i frytshëm dhe mbështetja e gjithanshme me DPRR, drejtorin z. Andi Toma dhe zv/drejtorin Skënder Çato e me grupin e deputetëve për tërheqjen dhe realizimin e këtyre investimeve në infrastrukturën rrugore, marrëdhënie të mira institucionale dhe të mirëkuptimit reciprok në dobi të realizimit të programit të qeverisë e detyrave përkatëse.

-Cilat janë projektet për të ardhmen në infrastrukturën rrugore?

-Projektet janë shumë ambicioze për të përbushur programin e qeverisë demokratike në infrastrukturën rrugore, sistemim-asfaltim Shëngjin-Kune, me vlerë 300 milion lekë, sistemim –asfaltim superstradë-Zejmen-Tale me vlerë 99 milion lekë, sistemim –asfaltim rruga e spitalit Lezhë me vlerë 35 milion lekë, sistemim-asfaltim rruga Lezhë-H. Gjetisë me vlerë 90 milion lekë, sistemim-asfaltim rruga e Vainit-I. Lezhë me vlerë 10.3 milion lekë, riveshje pjesore Balldre-Bisht-Jugë me vlerë 8 milion lekë, riveshje pjesore Balldre –Kakarriq me vlerë 10.5 milion lekë, riveshje pjesore Lezhë-Milot me vlerë 32 milion lekë (në rrethin e Lezhës). Në rrethin e Mirditës: riveshje pjesore Milot-Rubik, me vlerë 8.2 milion lekë. Në rrethin e Kurbinit: sistemim-

asfaltim superstradë Laç-Gorre -Patok me vlerë 280 milion lekë, janë dhënë 7 lote për ndërtimin e autostradës F. Krujë-Milot me vlerë 27 milion euro dhe po vazhdon puna me ritme të shpejta, janë në fazat e fundit të punimeve segmentet Milot – Skuraj-Rubik-Rrëshen. Këto investime janë realizuar gjatë periudhës 2006 - 2009 (kohë kur është drejtor z. V. Ndoja) nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve e drejtuar nga z. Andi Toma dhe Drejtoria Rajonale e Rrugëve Lezhë e drejtuar nga z. Valentin Ndoja, me përkushtim e profesionalizëm.

-Si i shihni zhvillimet politike të tanishme dhe e ardhmja?

-Unë jam anëtar i Partisë Demokratike që në fillimet e lëvizjes demokratike, me një kontribut të gjithanshëm si anëtar i devotshëm e kryetar i Grupseksionit të PD Ishull-Lezhë, ku në votimet e fundit

fitoi PD, unë vij nga nje familje e persekutuar nga regjimi komunist. Me fitoren e PD e koalicionit të saj, do të vihen në jetë projektet e nisura në infrastrukturën rrugore e në punësimin, lëvizje të lirë e mirëqenien e qytetarëve e integrimin e tyre në familjen e madhe evropiane.


-A përfiton zona turistike nga projektet për infrastrukturën rrugore?

-Padyshim që po. Prioriteti i programit të qeverisë demokratike dhe i yni si drejtori është në funksion të rritjes së nivelit të turizmit, duke u lidhur zonat bregdetare me infrastrukturën rrugore për zhvillimin e turizmit e thithjen e turistëve vendas e të huaj. Janë duke u hartuar projektet për ndërtimin e gjithë segmenteve rrugore turistike gjatë bregdetit të Adriatikut.

JAK RROZHANI

## FRAN GJOKA

### “LULET E KAINIT”



Pas romanit “Jerina, në dashuri të pamëkat” e “Eva në jetën e Kelit”, Ndue Gaspri del para lexuesve me romanin e ri “Lulet e Kainit”. Në qender të librit është jeta, përpjekja, sukseset e privacionet e një mësuesi të talentuar biologjie. Duke punuar në disa kolektiva shkollorë arrin të përçojë atje kontributin e punën e tij këmbëngulëse, tek nxënësit dashurinë për biologjinë e natyrën dhe tek mësuesit të zgjojë përpjekjet e përbashkëta për të patur në shkollë e rreth saj ambiente sa më edukuese. Me

punën e tij arrin të fitojë dashurinë e nxënësve e të ngrihet shumë në cilësitë e tij si edukues mental e i palodhur i brezit të ri. Duke zgjuar tek ata dëshirat për shkencën, arrin që nga një shkollë fshati, të përfaqësojë rrethin në olimpiadën kombëtare të biologëve e të zërë vende nderi. Model ky që nga njerëz të ditur përgjithsohet, por që prish hesapet e planet e politikanëve dritshkurtër që bëjnë gjithçka që të prishin e degdisin në rutinë pasionin, vullnetin e

dëshirën për punë të mësuesit Lorenc Jakini. Në liber, një vend të rëndësishëm zë dhe dashuria e zjarrtë e Lorencit me mësuesen Luçie Sarda, një personazh, që në ambientin ku jep mësim, vjen gjithnjë duke u rritur, jo vetem nga lidhja me mësues Lorencin, por dhe nga përpjekja e saj për të kapërcyer pengesat e kurthet meskine që e ndalojnë atë për të vazhduar shkollën e lartë. Dashuria, por dhe vdekja e saj janë kulmi i veprës, që çdo lexues e përjeton thellë e me dhimbje. Humbet një jetë njerëzore nga

më të ndriturat, ndërpritet një dashuri ndër më të ndjerat e vezulluese për kohën kur ndodh e zhvillohet. Përplasja me inspektorin Astrit është antagonizmi i kohës, që risjell në vëmendjen e lexuesit gjithë atë kakofoni zërash kundër një elementi që mendon e vepron ndryshe në një shoqëri të marginalizuar që po kalonte populli ynë. E pas Astritit fshihet një makinë e tërë partiake e shtetërore që tenton të mpakë, të rrudhë, të bëjë nul çdo levizje e tentativë të mendimit e veprimit të lirë. Lidhja me Lenën e krijimi i familjes me të, janë me më pak zjarr, por me shumë maturi e prudencë sociale në kushtet kur të mbyllen të gjitha shtigjet e jeta të afron mundësi të pakta, por dhe këtu shfaqen vlerat njerëzore, bile ndonjëherë merr permasa të një gjykimi të ndjeshëm deri në thellësitë e analizës së ftohtë e integrale. E mësuesi Lorencia arrin të mbijetojë, të sendertojë idetë e dëshirat e tija në një realitet gri, por kjo tregon forcen e njeriut me vullnet, që mposht dhe dilemat në shpirtin e tij. Futja e dalja nga politika e mësuesit Lorenc, për nga mënyra e shtjellimit të ngjarjeve, është mjaft e motivuar artistikisht dhe e shkruar me një rrjedhë logjike të admirueshme. Autori ka punuar për një kohë të gjatë mesues, nje mirë dëshirat e nxënësve, ambientet shkollorë e sfidat e saj, ndaj libri është shkruar me dashuri, pasion e me një gjuhë të pasur në pasazhe e momente të këndëshme artistike. Dhe në fundin e romanit, ku përjetohet një braktisje e stisur nga jeta, mësuesi mbetet mësues dhe kur shfaqet mes njerëzve e gjen aty dashurinë e tij, ku nuk mungojnë as mësuesit e kolegët e tij të dashur për të dhe nxënësit e radhës. Duke artikuluar perceptimin e autorit në lidhje me ngjarjen dhe ngjarjet reale të kohës brenda një realiteti ku zotëronte

meskiniteti dhe tutela politike e partiake e një sistemi të çmendur në “pagabueshmërinë” e tij dhe në “overdozën” ideologjike që përpiqej të injektonte në mendjet dhe ndërgjegjen e njerëzve, mund të themi se libri ka një kapacitet intelektual mjaft të pëlqyer dhe frymë interpretimi realiste. Por, deri në fund të kësaj veprë, nuk është vetëm problemi i një mësuesi apo i disa mësuesve që na vjen deri tek ne, por është shoqëria që, duke kuptuar në mënyrë të vazhdueshme, vjen e piqet deri në maisje dhe shpërthen vullshëm. Është një shoqëri e etur për drejtësi, liri dhe vlerësim real të personalitetit të njeriut, jo të kultit, por të shoqërisë në një demokraci të mirëpritur. Fatkeqësisht, autori, me mjeshtri, na ka dhënë ato elemente që tronditen brishtësinë dhe aspiratën e kësaj shoqërie në fillimet entuziazte të një jete dhe fryme të re në ecjen para. Shumë veta u zhgënjyen dhe mbeten jashtë dëshirës së tyre për një “ëndërr” të realizuar. Përsëri drejtimin e morën ata që kishin ndrruar formën, por jo përmabajtjen. Kjo ia rrit vlerat romanit “Lulet e Kainit”, duke e bërë atë një emblemë e një kohe të re, ku dëshira dhe realiteti nuk gjeten asnjëherë përputhjen e duhur. Personazhet vijjnë natyrshëm, ku secili nga ne mund të thotë pa droje se dhe unë isha kështu, se dhe unë dashurova kështu, se dhe unë vuajta kështu, se dhe unë u zhgënjeva kështu...! Autori, Ndue Gaspri, deri tani, në triptikun e tij, i ka sjellë lexuesit vepra realiste, me format shumë të qartë artistik dhe logjicion intelektual të arrirë. Them pa frikë se janë librat suprizë të këtij autori, që mbajnë dhe peshën kryesore në të gjitha botimet e këtij lloji në Lezhë për nga arritja artistike dhe gjetja e realizimi ideor.

## KOREOGRAFIA –ËSHTË PJESË E JETËS SIME. -Intervistë me koreografin e talentuar, Gazmend Golemi-



-Koreografi i mirënjohur lezhian, Gazmend Golemi, vazhdon të përgatisë balerinët e ardhshëm, të cilët debutojnë me sukses në skenat e ndryshme, këtë fidanishte të së nesermes të tre moshave 5-16 vjeç, të pagëzuar me emrin "Eagle Dance", duke interpretuar valle të autorëve vendas e të huaj. Nënësiti e thërrasin "Profesor", aktualisht i papunë,



në aktivitet artistik privat, ky grup shkon 80 veta, një koreograf i qeshur, komunikues e tepër profesionist. Po kush është koreografi i njohur Gazmend Golemi? Ka lindur dhe banon në qytetin e Lezhës. Është ndër të parët pionierë të lëvizjes koreografike si dhe solist që në hapjen e parë të grupit të valltarëve pranë Shtëpisë së Kulturës Lezhë, sot QKF. Që nga viti 1969 deri më 1978 ka qenë ndër promotorët e ndër përfaqësuesit më të mirë të valleve të folklorit dhe të aktiviteteve lokale e mbarëkombëtare në Lezhë e Shqipëri. Më 1979 mbaroi kursin e Koreografisë pranë Shtëpisë Qendrore të Krijimtarisë Popullore, Tiranë me rezultate shumë të mira, më 1979, pas koncertit madhështor

të zhdukjes së pasojave të tërmetit, emërohet koreograf i rrethit të Lezhës, më 1989 mbaron Akademinë e Arteve të Bukura, Tiranë.

-Cili ka qenë aktiviteti juaj artistik?

-Aktiviteti im ka qenë shumë impeniues, i larmishëm e largpamës që nga ajo periudhë e deri sot. Kam lëvruar dhe zhvilluar fushën e artit koreografik në qytet e në rrethin e Lezhës. Janë ndërtuar grupe baleti në të gjitha ndërmarrjet e asaj kohe, në të gjitha shkollat e mesme të rrethit, në të gjitha kopshtet me drekë, në të gjitha kooperativat bujqësore të asaj kohe dhe nga gjithë këto është përzgjedhur trupa qendrore e Pallatit të Kulturës, Lezhë.

-Pas gjithë kësaj pune voluminoze, cilat janë vlerësimet?

-Gjatë kësaj periudhe, unë si koreograf jam nderuar me çmime lokale e mbarëkombëtare. Në vitet 1978, 1983, 1988 nderohem për hulumtimin, gjetjen, trajtimin, koreografinë, kostumografinë me çmime nderi dhe shumë prej tyre kanë mbetur perla në koreografinë shqiptare në Institutin e Kulturës Popullore dhe në Festalet Kombëtare të Gjirokastrës. Jam duartrokur si koreograf i tre premierave Ansambli "Çiftelia" Lezhë, 1981-1983. Më 1981-1982, në takimet e klasës punëtore, jam nderuar me fletë nderi për trupën e baletit dhe për koreografinë bashkëkohore të trajtuar në atë kohë. Pranë Shtëpisë së Pionierit të asaj kohe u ngritën dy trupa baleti: i të vegjëlve e i të rriturve, të cilët patën një aktivitet jashtëzakonisht të larmishëm në të gjitha aktivitetet brenda rrethit e jashtë tij.

-Cila ka qenë puna konkrete si koreograf me grupmoshat?

-Jam marrë vazhdimisht me grupmoshat e ndryshme, duke filluar nga 5-35 vjeç që nga 1979, 1985, 1989 deri sot, punë e cila ka patur frytet e sukseset e veta. Më 1985 kam mbaruar kursin e dytë të

Koreografisë pranë shtëpisë Qendrore të Krijimtarisë Popullore me rezultate të shkëlqyera, më 1989 mbarova Akademinë e Arteve të Bukura Tiranë, me rezultate të larta, ku marr titullin nga Komisioni Shtetëror "Koreograf", në katër vitet e shkolles e në diplomë jam vlerësuar me notë maksimale 10 në degën e koreografisë. Emërohem drejtor në kooperativën Ishull-Lezhë 1989-1992, ku pata rezultate shumë të mira në punë, duke marrë çmim të parë në takimin e estradave si dhe flamur në takimin e dramave në shkallë rrethi, dërgohem në Blinisht për të forcuar pozitat e kulturës në atë zonë, më 1992 thirrëm si specialist për të përfaqësuar grupin koreografik nga treva e Lezhës në Festivalin e Mesdheut, Agrigjenda, Itali, ku grupi i Lezhës, ndër 28 shtete të Mesdheut, u nderua me çmimin e parë falë koreografisë time. Kam punuar nga 2003-2006 herë mbas here me kontratë pranë Bashkisë, Lezhë, më 1 prill 2006 emërohem koreograf specialist pranë Pallatit të Kulturës, Lezhë, më 2006, me një nostalgji dhe mall të pufukishëm, u



përballa me Festivalin e Valleve Folklorike Mbarëkombëtare në Lushnje, ku nderohem si koreograf dhe si trupë me çmim nderi. Largohe me motivacionin e suprimimit të vendit të punës në tetor 2007 nga Bashkia, Lezhë, për arsye të panjohura e të paspjeguara deri sot.

-Ndërkohë aktiviteti vazhdon si dhe dhënia e çmimeve?

-Edhe pse i papunë, jetën kulturoro-artistike dhe të lëvritimit të artit koreografik nuk e kam ndalur për asnjë çast, duke realizuar një trupë baleti prej 80 kërcimtarësh nga moshë 6-18 vjeç të këtij komuniteti pranë QKF Lezhë, të cilët bëjnë të mundur mbulimin e të gjitha aktiviteteve të Lezhës e jashtë saj, mbulojnë të gjitha aktivitetet në shkallë rrethi, si QKF Lezhë dhe Bashki Lezhë, me një përkrahje dhe dashuri nga të gjithë prindërit e Lezhës. Në mbështetje të QKF Lezhë janë realizuar dy aktivitete të veçanta në shkallë republike, titulluar "Mbrëmje Koreografike" nga trupa e baletit "Eagles Dance" më 2007 e 2008, që u mirëpritën shumë mirë si brenda Lezhës dhe jashtë saj. Brenda këtyre dy aktiviteteve të trupës së baletit "Eagles Dance" 2007-2008, u paraqiten mbi 18 koreografi të reja të panjohura për publikun lezhian. Vlen të theksohet se për herë të parë në historinë e zhvillimit të artit koreografik në Lezhë, kjo trupë doli me baletin me një akt "Emigracioni" si dhe një koreografi e shoqëruar me recitim, që solli risi në skenën e Lezhës dhe gjithë veriun. Kjo trupë ka marrë pjesë në koncertin e madh festiv nëntor 2006 "Një kulturë, një komb" në Tiranë, ku morën pjesë shumë trupa nga mbarë Shqipëria e jashtë kufijve. Më 2008 në Festivalin Mbarëkombëtar në Fushë-Arrës, një pjesë e kësaj trupe u nderua me çmim të parë mbarëkombëtar, ndërsa më 2009, duke parë suksesin e kësaj trupe, RTSH përgatit dhe dha një program të veçantë me koreografitë e mia të filmuara në natyrën e bukur të Lezhës, i cili u pëlqye shumë.

-Ju uroj suksese të mëtejshme në talentin tuaj në të mirë të vendit!

-Falenderimet e mia dhe për ju e gazetën simaptike "Lissalba", e cila ka mbijetuar me sukses deri më tani!

JAK RROZHANI

## ZBRITJA NË HËNË E "APOLLO 11", REALIZIM I NJË ËNDRËRE TË NJERËZIMIT

Zbritja në Hënë e ekuipazhit të "Apollo 11" me 20 korrik 1969 ishte kulmi një ëndërrë të shumëpritur. Kjo arritje madhështore shënoi edhe përfundimin e një faze të programit amerikan të hapësirës dhe fillimin e një tjetre. Suksesi i misionit "Apollo 11" hapi perspektiva të reja për misionet e ardhshme të Nasës. Misioni zgjeroi aftësitë njerëzore dhe ofroi një pamje të Tokës nga një perspektivë e re. Amerika u krenua me këtë arritje, pasi ajo kishte mbetur pas Bashkimit Sovjetik në ditët e para të garës së hapësirës.

Jim Burke ka qenë inxhinier i Nasës dhe ishte pjesë e garave fillestare. "Ishim në një garë paqësore por shumë të fortë me një kundërshtar të papërkulshëm i cili ishte i etur për të arritur para nesh në çdo destinacion të ri të sistemit diellor. Ishte një garë e shkëlqyer dhe tejet entuziasmuese në të dy anët." - kujton ai. Amerika u përqedrua në fluturimet hapësimore me njerëz me pesë misione në Hënë, që përfunduan në 1972. Si SHBA, ashtu edhe Bashkimi Sovjetik vazhduan gjithashtu programet hapësimore pa njeri. Ata dërguan sonda në pikat më të largëta të sistemit diellor dhe më pas zbritën paisje robotike dhe eksploruese në planetin Mars. Teleskopi Hubble në orbitën përreth Tokës ka dërguar foto spektakolare të sistemeve jesh tejet të largëta. Në 1980, Shtetet e Bashkuara i kufizuan fluturimet në hapësirë pas ekuipazh vetëm në orbitën e tokës, fillimisht me programin e anijeve për vajtje ardhje në hapësirë, dhe duke filluar në 1998, me Stacionin Ndërkombëtar të Hapësirës. Në këtë projekt përfshihen Shtetet e Bashkuara, Rusia, Japonia, Kanada, Brazili dhe 11 vende evropiane. Dy aksidentet tragjike ndryshuan programin amerikan të hapësirës. Anija "Challenger" u shkatërrua pas ngritjes në 1986, duke vrarë të 7 astronautët dhe "Columbia" u shkatërrua gjatë kthimit në Tokë në 2003, me 7 astronautë në bord.

Në Shoqërinë Planetare në Pasadena, Kalifornia, drejtori ekzekutiv Louis Friedman thotë se aksidentet çuan në kontroll dhe pavarësisht aksidenteve, një angazhim të eksplorimeve njerëzore përtej orbitës së Tokës. "Njerëzit janë eksploratorë. Ndaj idetë pas kësaj, kostoja dhe rreziket kërkojnë një destinacion, sepse duhet të eksplorojmë botë të reja." - thotë ai. Në vitin 2004 presidenti Xhorxh Bush njoftoi një synim të ri për rikthimin në Hënë deri në 2020. Dhe me Hënë si bazë, dërgimin e njeriut në Mars pas viteve 2030. "Një hap i vogël për njeriun, po një kapërcim gjigand për njerëzimin"... - do të thoshte njeriu i parë në Hënë, Neal Armstrong. "Misionet Apollo hapën perspektiva të reja. Apollo ishte një demonstrim se njerëzimi nuk është i lidhur përgjithmonë tek ky planet", - tha ai. Edhe vendet e tjera u bashkuan në eksplorimin e hapësirës. Astronauti i parë kinez fluturoi në orbitën e tokës në 2003. Ndërsa një sondë indiane u ul në Hënë nëntorin e kaluar. Louis Friedman thotë se trashëgimia e Apollos për garë paqësore ka vazhduar, por gjithashtu ka hapur rrugën për bashkëpunim, ndërkohë që njerëzimi zgjeron njohuritë për Tokën dhe hapësirën.

“KËSHTELLE E SHPIRIT”, POEZI E JUTORI AGIM DASHI



Për më shumë informime... Për më shumë informime... Për më shumë informime...

ATEM KREMY

Gjon NDREJA

Të nderuar Lexues, më poshtë po Ju paraqes disa dokumente që kam mundur t'i mbledh dhe që flasin për historinë e Mirditës, veçanërisht për periudhën kur ajo u shpall Republikë në Prizren, në vitin 1921 dhe kërkoj njohjen si të tillë nga Europa dhe Lidhja e Kombeve.

REPUBLIKA E MIRDITËS (Sipas Eikipedia, the free encyclopedia) Republika e Mirditës ishte një republikë jetëshkurtër e shpallur në veri të Shqipërisë nga Gjon Markagjoni dhe ndjekësit e tij. Ajo ekzistoi që prej 17 Korrikut dhe deri më 20 Nëntor 1921. Jugosllavia e përkrahu Gjon Markagjonin, i cili i udhëhoqi anëtarët e fisit të tij katolikë në një revoltë kundër regjimit dhe parlamentit shqiptar i ngritur pas Luftës së Parë Botërore.

II. FAMUJT E REPUBLIKËS SË MIRDITËS, 1921

Flamuri i Republikës së Mirditës – Imazhi nga Jaume Ollé, 15 Korrik 1996



Serbët përfituan nga beteja midis Shqipërisë dhe Italisë për të pushtuar një pjesë të vendit duke ngritur kështu republikën e Mirditës, por forcat shqiptare i dëbuan ata.

Flamur tjetër i raportuar i Shqipërisë – Imazhi nga Jaume Ollé,



Flag Bulletin Newsletter # 32 (10 Shkurt 1979) përmend Mirditischen Republik. Një flamur i pidentifikuar i është atribuar Republikës së

REPUBLIKA E MIRDITËS ( Përmes disa dokumenteve)

Mirditës ose Republikës së Koritzës. Ai ka tre shirita horizontale, të kuqe, të bardhë dhe jeshile. Në pjesën e kuqe, në qendër, është shqiponja e zezë me dy kokë. Flamuri i vërtetë mund të jetë ndryshe, sepse burimet e mia thonë që flamuri kishte një shqiponjë dy krerësh, por nuk thonë që ishte element i vetëm në flamur.

III PROKLAMATE ME RASTIN E SHPALLJES SE PAVARESISE SE MIRDITES

Vllazen kshtenim Mirdit e tan Dukagjini! Mirdit,1921

Ma shume se peseqind vjeteve kjem rob te TurkJies. Faleminders Zotit mas gjith mundit e mas gjith luftash jena libru asaj robnijet. Gjithe Evropa don qi Shqypnia tjen e librueme, qi me ken edhe ajo e ujdusun, qi me pas ruggat e qimendifferat e shkollat. Kjo asht fort bukur e mire. Kjo asht edhe dishiri jon, pse edhe na dona me ken zhdrivilluem, me pas shkolla jo sadhde fmija jone pore edhe na pleqt kena qef me msu me shkru e me kndu- pse njaj popull qi asht i zhdrivillum njato shkojn per para me pun. Po na vllazen, qi e njofim mire turkun, mundena me zan bese, qi me ycymet TurkJiet ne Tirana ? A mundena me besu qi kan me na dhan desturdhek, qi ata ne per para peseqind vjetve na kan majt si robni ? A mundena me ken me at ycym, qi don me na up fenë ton, qi na ndes e naj up katundet tona? A mundena me duruë me ken nen ket ycym e ne ket urdhun, qi sot tpart e Turqnit agik flasin. "Qi ju keni ken raja e jon tesh pesqint vjet, e keni prep me ken raja e jon" JO VLAZEN ! Na nuk e dona robnin e Turqnit! Na dishrojm lirin e bashkimit mu sjedh per smarit, pra kush dishiron mu sjedh per smarit nuk mundet mu Ishu, qi TurKija mu jerëtis e rrë si ka kenë SHQYPËTAR! Ne daçim me krijua një derzav nen ycymet te TurkJies n' Tirana at err na vedvedit i kena vuë prangat ne dorë e ner kamë. At err kthej prap nat vakt, qi ne na kan shkel, kur skena ken tzot me RFYE FENE TON, kur skena mujit me GODIT KISHT TONA, kur skena guzuë me vuë kumont ne kompanjela ton e kur na kan myt MESHTART TON. Me dvertet njat vakt asni SHQYPTAR I DRET nuk e dishron. Ne kjoft qi at vakt nuk e dishrojm, pra na duet me GJITH FORZADE TONA me pumië, qi kjo pun mos me na baë vaki. Per ket pun Mirditsit e kena ap lirin ton republik. Per ket luftojme me pushk n'dorë kundra ycymetit tirans e kerkojm prej Evropet, qi me na njoft. Delegazoni i jon n'Zenevë ne konferenz Shocnis Popudhit ka mryt, qi ne Shqypni mu cu komisoni per mu pvet popudhi, se cka lypin. Ne konferenz n'Zenevë ka ken deri tesh delegazoni i Tirans, qi ka fol qi asht TAN SHQYPNIA me Tirana, e dhe ka ap ma t'reshetet fjalt per kapitan Marka Gjonin ton. Të ardhunit delegazonit Mirdits n'Zenevë ka met ycmi i Tirans i marrum prej fjalve t'reshme, qi kan fol per Mirdit e per gjith kshtenim te Shqypnis. Kush i ka nimu ycymetit Tirans n'Zenevë ? Taljant, qi jan anmiqt ton, kuja asht ascerija QI KA BA KISHEN SHTADH, edhe na ka mar erzin grave e varzave tona. E kush i ka nimu

delegazonit Mirdits ? Serbia e cila asht ne konferenz ne Paris t'pagjt i ka dalzot liris ton. Serbija asht miku i jon e don me ken KOJMISHI I MIRE. SHQYPËTAR Per pak dit ka me ardhe komisija e Shoçnis Popudhit Diftoni sbashkut: Nuk e dona ycymetin e TurkJies t'Tirans! Kshtenimi i Shqypnisë don derzaven e lirin e vet, jose dot luftojn deri ma t'mramin pik gjakut SHQYPËTAR Tjemi t'sbashkum e mos u rreni fjalve t'reshme Tirans e Italis Marrë nga http://ëëë.geocitie.s.com/djalosh/markagjon.html

IV.PULLA POSTE TE EMETUARA ME MBISHKRIMIN "VETEKEVERRIA E MIRDITES"

V.EDITH DURHAM: KJO ËSHTË MIRDITA Mirdita numëron rreth tri mijë shtëpi. Të gjithë janë katolikë. Përbëhet nga pesë bajrakë, prej të cilëve Oroshi, Spaci dhe Kushneni janë nga i njëjti gjak me Shala-Shoshin dhe nuk marrohen as midis tyre, as me Shalen e Shoshin. Ata kanë ardhur nga malet e Pashtrikut, pranë Gjakovës, kur turqit e pushtuan vendin për herë të parë. Lekë Dukagjini, - thanë ata, -ka qenë një nga të parët e tyre dhe sundonte në të gjithë malet në kohën



e Skëndërbeut: Lura ishte pjesë e tokave të tij. Skëndërbeu sundonte më në jug. Lekës ia zuri vendin i nipi, Pali i Bardhë dhe pikërisht nga shtëpia e tij rrjedh fisi malazias Bjelopavliq (biri i Palit të Bardhë), ndonëse tani ai është fis serbofon dhe ortodoks. Thoshin se Skëndërbeu dhe Leka ishin të lidhur mes tyre, prandaj gratë mirditore mbanin xhurdi të zezë ne shenjë zie për Skëndërbeun: në të gjitha fiset e tjera xhurdia mbahet vetem nga burrat. Por nuk ekziston ndonje gjenealogji autentike, as unë nuk arrita të hartoja nga gojëdhana një gjenealogji të pranueshme... Të zotët e shtëpisë u habiten me taksat që paguajmë ne në Angli dhe shprehen mendimin se kjo fliste për një qeverisje shumë të keqe. Marr guximin të them se, ata kanë të drejtë. Por ata e pranuan se në Mirditë vetem për gjak paguhej një taksë shumë e madhe. Mirditasit nuk e ruajnë aspak koken, siç bëjnë mjaft fise të tjera. Në shumë raste, në të vërtetë, ata ruajnë vetem një rrip të ngushtë në tëmthat. Meqë dy nga pesë bajraquet janë me gjak të ndryshëm, nuk është për t'u çuditur që tipi është mjaft i ndryshëm. Ndeshen shpesh si burra shtatgjatë me sy bojë hiri, ashtu edhe burra të shkurtër, zeshkanë, bashkë në raste kalimtarët e ndërmjetme. Udhëtarët, që i përshkruajnë gjithë mirditorët si "zeshkanë" ose "flokëverdhe", kanë vizituar vetem një pjesë. Me sa di unë, asnjë mirditor nuk bën tatuazh... (Marrë nga "Shqipëria e Eperme" e Edith Durham).

## KIMZA E MIRDITËS, SELI E QEVERISË SË PËRTASHME TË SHQIPNIS

Mbase titulli i këtij shkrimi është disi paradoksal për lexuesin. Po shpjegojmë që në fillim: Fshati Kimëz është i bajrakut të Spaçit. Spaçi është njëri nga 12 bajrakët e Mirditës etnike. Në Kimëz të Spaçit më 17.4.1911 është formuar Qeveria e Pertashme e Shqipërisë që frymëzoi e udhëhoqi lëvizjen për pavarësi të malësive të Veriut të Shqipërisë. Patriotët shqiptarë, për të mbështetur me ndihma materiale dhe armë kryengritjen e vitit 1911, krijuan në Podgoricë një komitet, i cili njihet nga historia: Komiteti Shqiptar i Podgoricës. Për këtë rol të rëndësishëm luajtën Luigj Gurakuqi, Hilë Mosi, Risto Siliqi e të tjerë. Ky komitet siguronte edhe bashkërendimin e veprimeve me komitetet e tjera kombëtare. Komiteti Shqiptar i Podgoricës organizoi kryengritjen e Malësisë së Mbishkodrës dhe nxiti dhe bajrakët e tjerë duke çuar anëtarë të atij komiteti në Dukagjin e Mirditë. Fitoret e kryengritjes së Malësisë patën jehonë e ngjallën shpresë për shpalljen e pavarësisë. Edhe diplomacia evropiane, që e simpatizonte këtë lëvizje, u entuziazmu. Prengë Marka Prenga, bajraktari i Oroshit, me porosi të Emz. Prend Doçit, ngriti flamurin e kryengritjes në Mirditë, rreth të cilit u bashkuan shumë krenë e kryengritës. Në këtë kohë Terenc Toçi me Spiridjon Kacarosin, Beb Shantojën, Filip Ujkën e shkodranë të tjerë, shkëputën nga Malësia e Madhe dhe dalin në Mirditë pranë kryengritësve. Po kush ishte Terenc Toçi? Ai ishte arbëresh nga Kalabria. Kishte lindur në Shën Kozmo Albaneze të Kozencës më 9 mars 1880 në një familje të shkëlqyer dhe të shquar për tradita atdhedashurie. Mësimet e para i mori në kolegjin shqiptar të Shën Mitër Koronës nën drejtimin e Jeronim de Radës. Më 1901, duke qenë student për drejtësi, në një kohë kur opinioni botëror e diplomacia evropiane vinin në dyshim vetë ekzistencën e kombësisë shqiptare, Terenc Toçi botonte broshurën e flakët me emrin "Questione Albanese" ("Çështja Shqiptare" - M.Z.), Kozencë 1901, nëpërmjet së cilës mbronte të drejtat kombëtare të popullit shqiptar. U diplomua në drejtësi. Terenc Toçi, duke qenë nxënës i De Radës dhe i mëkuar me veprën e Gavril Darës- Plakut e të Riut, në shpirtin e tij u brumos një dashuri e pakufishme për Atdheun e të parëve e, veçanërisht, për Mirditën si kështjellë e pathyeshme e simbol i qëndresës shqiptare përballë sulmeve të Perandorisë Osmane. Siç duket, i entuziazmuar nga kryengritja shqiptare e 1911-ës, boton në Milano broshurën përmbi Shqipërinë me titull "L'Albania e gli Albanesi" ("Shqipëria e Shqiptarët" - M.Z.), e cila u shpërnda në të katër anët e Italisë. Po më 1911, në bashkëpunim me atdhetarë shkodranë, shkoj nga

Milanoja në Mirditë për të organizuar kryengritjen e Shqipërisë së Veriut kundër pushtuesve otomanë. Terenc Toçi gjithë jetën ia kushtoi Shqipërisë e çështjes shqiptare. Dhe tani, duke i kërkuar të falur lexuesit për shmangien nga tema e shkrimit, le të kthehemi në hullinë e saj. Qendra ku u mblodhën të gjithë përfaqësuesit e trevave të Malësisë së Veriut ku zhvillohej kryengritja e 1911-ës, u bë Kimza e bajrakut të Spaçit në Mirditë. "Në marrëveshje me krenët e vendit qitet kushtrimi, mblidhen 12 bajrakët. Hapet zani se kan ardh gjind prej krajlash. Lidhet besa, formohet një qeveri e perkohshme, bahen shpalljet e lajmohet bota e gjytetnueme me anë të një proklame. Vendojnë të marrin Lezhën e të hapin udhën e detit prej kah presin ndimat e premtueme", - thuhet në shkrimin "Mirditë Bregmatë", i botuar në revistën "Leka". Në Kimëz të Mirditës Terenc Toçi me përfaqësuesit e sipërpërmendur së bashku me kryengritësit më 27.4.1911 formuan Qeverinë e Përkohshme të Shqipërisë.

Më poshtë po japim tekstin e besës së lidhur dhe të shpalljes së vetëqeverimit të botuar në revistën "Leka" në shkrimin e përmendur më lart: GEVERIJA E PERTESHME E SHKJPENIS SHKJPENIA E SHKJPETARVE Gims 27.4.1911 T'nenshkruemt tuj mennue ci gjith popudhi ja Komi shcypitar si t'kshten si muamedan, ka gjith t'drejtat e arsyenat ci me neltue e me e mallnue si stet, t'liir e n'vedi Komin e Shcypniis, e ci t'kishte pas vanes kymenim kishte ken gni resik per ne, tuj pasë knue e nii dishiret t'ona e t'spjegum prei gith krahinave, t'nahijes s'onë e po diftojn Shcypniin t'liir e vetceverimsume ner kufit e vet, ner istoria t'veta, n'ghiu h t'vet e ner kombe t'veta; e Kan dhan t'gith Bessen. E kto vet po diftohen ceveritar t'veneve veta nen emen T'ceverist Perteshme t'Shcypnis tuj dhanë Zotni Dr. Terenc Tocciit parsiin e liriin e plot per me menue sa asht nevoja per Ceveriin e Perteshme. Ceveria e Perteshme ka me u munue per luft e per liri t'plot e per form t'ceveriis t'pergjithshme ja me zgjedh Rrepublik ja krajl e gith punve tjera t'venit ton ci dan ma per rregull. C'far do punet t'pa ghiashme e t'pa arsyeshme ci t'bahet kunra ceveritarve t'ceveriis t'perteshme, sikur disa ginve ja t'gias tjetere kuj, e me dokonii jabangis, aj niri ka me mujt me ken gikue per dek. Selia e Ceveriis t'perteshme ka me ken per tesh në Ghims, 27,4,1911 (gisht) Dod Ffroku bajraktari i Kushnenit (,) Prenk Tuc Doda prej parjet t'Fanit vuni gisht Ndue per Deda per te. Dr. Terenc Tocci (vulë) Ndue per Deda prej Gojanit (vulë) Dod Bardhoku i Kthedhs (gisht) Kol Marka Kola prej kapidanash (gisht) Preng Marka Prenga prej kapidanash (gisht) Nue Frok Deda (vulë) Marash Nika

bajraktari i Shalës (vulë) Gelosh Kola bajraktari i Shoshit (vulë) Pren Uka bajraktari i Berishs (vulë) Frok Kola bajraktari i Thacit (vulë) Sadri Luka krye n'Theth (gisht) Gion Difi krye i Merturit me t'sadhakten per bajraktarin e Merturit. (gisht) Mark Sokoli per bajraktarin e Nikajve (,) Cerim Ndou n'ven t'bajraktarit t'Toplans (,) Prel Tuli i Merturit (,) Nue Marka Ddesh Kola prei Giugiet t'bajrakut Fanit vuni gisht per te Kol Marka Kola (,) Zef Noj prej Ghims t'bajrakut t'Spacit (,) Nue Nrez Lazri i Corthpuls t'bajrakut Dibres (,) Nue Gion Nozi prej Kushnenit vuni gisht per te Nue per Deda unë Ghega Filip Ciunit per skoder (gisht) Prenk Marka Gieta t'bajrakut t'Kthedhs vuni gisht per te Dodë Bardhok Doda (gisht) Nrez Giegia t'bajrakut t'Kthedhs vuni gisht per te Dod Bardhoku vula e rumbullakët

GOUVERNE PROVISORE  
GEVERIA E PERTESHME

D'ALBANIE

E SHKJPENIS

Kjo Qeveri e Përkohshme ndërmerr veprime konkrete për të realizuar synimet. Caktohet dita për të mësyre Lezhën. "Bin n'Ungrej te Ndue Kol Marku e ne nesre dajnë fjalët m'u pjekë te Qafa e pazarit me kryengritsit e Kashnjettit e tjerave krahinave. Marrjen e Lezhës e thymjen e depojës për t'u armatosë, e bajnë në asgja, janë të sigurtë se do të dalin ngadhnyjsa me gjithse të pa armë e pa municijone." (Rev. "Leka")

Të nesërmen kryengritësit, të armatosur dhe të pajisur me ushqime, zbresin nga Sukaxhia për të rënë në Lezhë. Dalin në kështjellën historike të Lezhës dhe prej andej sulmojnë ushtrinë turke. Kajmekami i Lezhës, i befusuar, mbledh ushtrinë dhe sulmon kalanë ku gjendeshin kryengritësit. Kryengritësit i bënë ballë sulmit derisa u mbarua municioni. Pritnin se do t'u vinte furnizimi nga Shllinza, por nuk u erdhi. Në këto rrethana kryengritësit e lënë kështjellën e mezi shpëtojnë kokën. Në Mirditë u përhap lajmi se kryengritja dështoi. Ushtria turke e Vaut të Dejës ngjitet përpjetë nga Gryka e Gjadrit e zë vend në Kalivaç. Me të ishte dhe kajmekami Ali Fehmi Kosturi. Në ato ditë një i dërguar nga Malësia e Madhe, një djalë nga Selca, shkon te famullitari në Kashnjët, i ngarkuar nga paria e vet me u lidh me Mirditë që, për çdo shkresë që do të bëhej për t'ua paraqitur krajlave nga ana e Malësisë së Madhe, të ishte dhe përfaqësuesi i Mirditës për të rënë në marrëveshje që çfarë të bënte njëra krahinë, të bënte dhe tjetra. "Si veprim të parë të kësaj solidarsije Mirdita çrregjistrohet prej "zaptjelleku", këputë çdo marrëdhënie me "hyqymet". Mbet pa vendas ushtria turke kthen e bje në Vadejë. Ngadhnyjimi i Malcis së Madhe pezulloi çdo veprim tjetër. Pritej lëvizja e premtueme e me këto shpnesa

prendoi vj. 1911." (Rev. "Leka") Perandoria turke, nëpërmjet Valis së Shkodrës, me qëllim që të përçajë besëlidhjen e maleve, thërret mirditorët të shkruhen rishtas zapti. Sigurisht që pati hallexhinj që thyen besën e iu përgjigjen thirrjes së Valis. Por parijsa e vendit me Prengë Marka Prengën në krye, që drejtonin edhe kryengritjen, që të mos përhapej kjo e zezë, vendosën për të dhënë ndëshkime. Kështu në Mnelë u dogjen 7 shtëpi të zaptive të shkruar rishtas. Shtëpi u dogjen për zaptitë e shkruar rishtas edhe në Rras, në Kastër, në Gjobardhaj, Shpaz, Kaçinar, Gjazuj e Korthpulë. Në Vig hynë dorëzanë për kthimin në vend të atyre që ishin veshur zapti. Këto veprime e vendime bënë që të gjithë mirditasit e veshur zapti nga hyqymeti të kthehen në vend dhe Turqia të dështonte në planet e saja për të përçarë Mirditën e për të shuar kryengritjen e Maleve. Në majin e vitit 1912 kryengritësit mirditorë lidhin besë me kryengritësit e Zadrimës. Kryengritësit mirditorë e zadrimorë sulmojnë ushtrinë turke në Naraç. Më 7 maj 1912 gjithë dita kaloi në luftim ndërmjet kryengritësve e turqve. Nuk jepen të dhëna për të vrarët e ushtrisë turke dhe as ndër kryengritës. Edhe më 8 maj 1912 lufta bëhet e rreptë ndërmjet kryengritësve (mirditorë e zadrimorë) e ushtrisë turke. Në këtë luftë u vranë 7 ushtarë turq. Entuziazmi dhe optimizmi i kryengritësve rritet. Nga Sheldija, çeta e udhëhequr nga dom Loro Caka e Simon Doda del në kep të Sheldisë dhe çon dy vetë për t'u marrë vesh me kryengritësit në Naraç për të bashkërenduar veprimet për një mësymje të frytshme. Edhe Prengë Marka Preng me kthellas e të Malësisë së Lezhës, ata që janë me pushkë, bashkohen e zbresin për të luftuar. Municioni i premtuar nuk u shkon kryengritësve. Po më 8 maj Prengë Pasha u çon fjalë kryengritësve në Naraç që rruga të lihej e lirë dhe teposhtë të kalonin edhe ushtarë po të ishin; ndërsa tërma ljo. Ushtria turke riorganizohet për të mësyre. Më 9 maj 1912 ushtria turke, e vendosur në kodrat e Rodhës, hedh 65 gjyle topi kundra një prite kryengritësish prej 35 vetësh që gjenden në kodrat e Vigut e në Kep të Hajmelit. Më 11 maj 1912 kryengritësit nuk luftuan, pasi ka ndërhyrë Prengë Pasha e mirditasit i binden të parit të vet. Ndërsa në kep të Sheldisë dom Loro Caka e Simon Doda vazhdonin luftën me të vetët. Më 16 maj 1912 në Naraç e në kodrat e Rodhës shkon Brahim Efendi, qatipi i Pashës, me urdhër që të mos bëhej më luftë e të shpërndareshin. Por kryengritësit nuk mund t'i zënë besë turkut. Ndërsa në Kallmet, në zall të Rraboshtës, 29 kryengritës kanë mësyre ushtarët turq e u kanë marrë 19 mauzere. Sipas ditarit të at Pal Dodës nga ushtria

turke mbetën 30 të vrarë e të plagosur, kurse nga kryengritësit dy të vdekur e tre të plagosur. Më 11 maj 1912 u bë një mbledhje edhe në qelë të Zejmenit ku ishte famullitar dom Pjetër Njeçi, i cili rrëfen hollësisht e asaj mbledhjeje. Ai thotë: "Aty gjindeshin parsimi i Mirditës, i Kthellës, i Malcis së Lezhës e i Bregmatës; Zef Marka Tuci përfaqson shpin e Gjomarkajve; prej Kthelle janë Dodë Bardhoku e Bardhok Prenga, bajraktari me tjerë; prej Malcis së Lezhës: Bardhok Kolë Toma, bajraktari i Velës, Gegë Pergega i Kryeziut, Kolë Gjakë Deda me bajraktarin e Manatis; Gjin Kola i Bulgrit me Gjo Gjakë Nduen, Marka Perzefin e tjerë. Gjithsejt nja 30 vetë. Në këtë mbledhje u mueren këto vendime: Mirdita e Kthella me u Ishue rrugë malsorvet të Bregmatës me bjeshkue nder meraja të tyne tue u dhanë letsinat e duhuna. Ditën e 29 Maj me i ra së

bashku depojes së Lezhës e me marrë armët. Si të fillojë pushka të gjith të besatuemt do të marrin qeverimin e Lezhës Mbas të vihet qeverimi kombtar në Lesh me vazhdue lëvizjen kah fusha e Zadrimës. Kryesija e këtyne lëvizjeve me i mbetë në ket anë shpis së Gjomarkajve. Me lanë në heshnje gjaqe e mnina gjatë levizjeve. "Itifaku" (Rev. "Leka"). Parija u mor vesh edhe me Toptanët në një veprim edhe në Shqipëri të mesme, sepse edhe ajo anë kishte shprehur dëshirën për të bashkëpunuar me kryengritësit veriorë. Sipas vendimit që u mor në mbledhjen e Zejmenit, më 29 maj, populli me spata e kmesa sulmojnë depot e armatimit në Lezhë, por ushtria turke i zbrapsi. Qeveria turke dërgon nja 400 ushtarë në kodrat e Bëdhanës (Pllanës) e 40 mushka me municion kur malësorët do të dilnin në bjeshkë, pra nga gjysma e

qershorit. Kur malësorët e Bregut të Matës po përgatitnin karvanet për të dalë në bjeshkë, disa malësorë të armatosur kishin dalë tek Ara e Trapit për të biseduar me gurzakët për të caktuar kohën e mënyrën se si me ia vu pushkën ushtrisë që po u zinte shtegun. Ndërkohë ushtria turke mbërriti. Malësorët ia fillan pushkës dhe bënë kërdinë mbi ushtrinë turke, e cila u vu në të ikur. Ja si përshkruhet beteja në shkrimin e cituar më lart: "Llesh Nika ( i Niksh) qi gjendej n'oborr të vet i rrethuem prej ushtarësh, mbas pushkëve të para me të cillat rrxon disa vetë, u ndry në kullë me t'an, me Nikë Staken e Mark Doken prei kah s'i lane me u avitë. Marrun mendsh ushtarët msyene rrugën e Lezhës me mushka e mitraloza. T'i pamen Dedë Coku u del para me pesë shokë, u a sjell pushkën e i ven në të ikun. Mbeten në dorë të këtyne 18 mushq ngarkue, 8 mitraloza e 24 kual

me pushkë e fyshekë. Shumë ushtarë mbeten në at luftë, dikush thotë 180 vetë do tjerë ma tepër. Prej malsorvet kan mbetë at ditë dy djelt e Mir Gjelit (Vukël), Nikollë Kolek Bori (Selcë), Mark Bici (Bregmatë); djali i Nikollë Sokolit (Niksh), kunata e nipi i Llesh Nikës e një kthellas. U plaguen Dedë Coku, Prengë Gjoka e e ama e Llesh Nikës. Në ket rasë kje tue bjerrë jetën Dedë Coku mos t'i vinte në ndimë një shoq, i cili ia njet doren dhe e nxjerrë prej hendeku bri të cilit një anadollak ishte avitë dhe ishte kahë e vritte mbas shpine." (Rev. "Leka"). Në verën e 1912-ës malësorët e Bregut të Matës veruan në bjeshkët e Mirditës në Mal të Shejtit pa asnjë lloj pagese për kullosë. Kapidanat u treguan shumë korrekt. Ata u zotuan se do të ishin të gatshëm t'u paguanin trefish çfarëdo dami që mund t'ua shkaktonte ndokush prej vendasve.

MARK GJ. ZEFI

A MUND TË PËRBALLOJMË VETVETEN?




Shpesh po ndeshemi në probleme, që, sa më shumë shkojmë para, aq më shumë na tërheqin pas. Jo rastësisht shkuam në shtëpinë e Ardian Gjon Palaj në një ditë pak të vrejntur korriku, që jo si vitet e tjera, erdhi me shira. Arësye ishte se kishim që në mars të vitit 2008 që, në bisedë me një mik, ishim njohur me një fenomen akoma të keq shqiptar që, për një ngatërresë fare banale, punët kishin shkuar deri tek kërcënimi me armë. Dhe si kishte ndodhur? Siç ngjet shpesh, nga një konflikt i nisur si shaka, kishte përfunduar në përdorim force dhe shtetasi Ndue Gjon Palaj kishte plagosur shtetasin Pjetër Kolë Pjetrin. Pastaj ishte larguar me shpejtësi dhe ishte strehuar diku përkohësisht me shpresën se do të mbyllet me pajtim ky sherr.

Por s'kishte qenë e shkruar, sepse shtetasi Pjetër Kolë Pjetri i kishte çuar fjalë familjes së Ardianit se do të vriste njërin nga vëllezërit. Ardian Gjon Palaj, i datëlindjes 16.06.1971, lindur dhe banues në Lezhë, vëllai i Ndue Gjon Palaj, nuk e kishte menduar dhe kaq serioze. Por më vonë e kishte kuptuar se gjendja ishte vërtetë e vështirë dhe se njerëzit këtu akoma gjykojnë mbi bazën e kanunit të vjetër dhe jo mbi bazën e një logjike të ftohtë në zgjidhjen e konflikteve. Që nga ai moment, Ardiani kishte çuar fjalë në shtëpi se nuk mund të qëndronte më nën trysinë e armëve, prandaj ishte strehuar tek një mik i tij dhe ishte nisur më tej jashtë Shqipërisë pa lënë adresë se ku. Që nga nëntori i vitit 2008 ai ka humbur gjurmët dhe është fshehur diku në një nga shtetet europiane për të mos rrezikuar jetën e tij. Po kështu dhe familja e tij janë ngujuar dhe nuk kanë guxuar të dalin nga shtëpia derisa në maj të këtij viti janë larguar dhe ata nga Shqipëria. Kanë ndërhyrë shumë miq e shokë për t'i pajtuar, ka ndërhyrë dhe Shoqata e Misionarëve të Paqes dhe të Pajtimeve të Shqipërisë dhe nuk është arritur asnjë rezultat. Familja e Pjetër

Kolë Pjetrit nuk pranon në asnjë mënyrë të pajtohet pa e marrë gjakun e saj sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit, i cili është respektuar për rreth 600 vjet në Shqipëri. Shqipëria, tashmë një

vend anëtar i NATO-s, aspirant për t'u futur në Bashkimin European si vend anëtar me të drejta të plota, i duhet të përballohet dhe me sfida të tilla të trashëguara në shekuj.

AGRON MUSTAJ



## GJON NIKOLLA, ITALI



F. Lame më pati thënë: -Miq, nuse, prindër e vëllezër ka vetëm në atdhe. Mërgimtari kudo është i vetmuar. Jo, jo, Lame, sot s'është krejt ashtu, sepse e keqja mundet vetëm nga të drejtët. Edhe e vjetra në kohë moderne përgatitka rilindjen e vet për të qenë edhe klasikja e radhës, për të pasur emër në kohra si "padi" e sigurtë e gjërave të shprehura... -Po ti këtu?- më drejtohet Sadiku në mënyrën e vet, Sadik Smaja. Ky, si e mira që endet nëpër njerëz, gjithë kohrat e freskët. Kamarierja na solli porosinë. -Ktheja! -sikur urdhëroi ky. -Por..., - deshi të thoshte kamarierja, Shefi. -I thuaj shefit ta paguajmë. Para nesh një djalosh. Në sup, sipër bluzës së bardhë, mbi krahun e majtë, peshqiri i



## AZGANI I DIBRES

pastër. Në pamjen e parë të mbushte syrin. Në fjalët e para të mbushte mendjen. Ngrohtësisht u përqaftua në mrekullinë që afron miqësia mes shokësh. Unë i dhashë dorën në masën që afroi rasti. "Diplomatja" ndoshta do të zgjatej edhe mbas 40 vjetësh në Itali me të vetmin djalë... Bashkim e quajti babai, Besim Sala. "Shefi", sot unë me të e një

historia e policisë dy emra bestarësh të kësaj arme, të më falë i treti, janë Gjeneral Ilmiu i Shkodres e Sadiku i Shqipërisë. - Mirë, mirë që pranon se ke gabuar, por do të fali që të mos e përsëritesh më. Thuaju dhe shokëve të tu që ... Dije se unë të kam njohur ty, ti njeh ata. Këto qenë fjalët e para e të fundit në besëlidhjen polici-popull. Sadiku instruktor partie, por



lidhje e kujtimit të babait na bashkon në nyjen që lidhi bukur e njerëzishëm Sadiku. Me Bashkimin e Besim Salës nga Lugjaj i Dibres. Sadiku, dëshmi krenare për të shpëtuar e ngritur imazhe në vullnete e dashuri besnikërie. Besoj se

sadik. Sadiku i shkarkuar, por Sadik. Sadiku polic, por Sadik. E koha e rasti kur po flasim, Sadiku Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, por prap e prap Sadik Smajë! Ky larg shtretër lëngatash të frikshme në xhelozitë politike



të ndërlikuara, që prekin zgjuarsis, në arsyetime imorale, si fundi i mençurisë të të mençurve, që sot prekin gjërat e thella që s'mund të mbyllen me një "Më vjen keq!". Asokohe, për sa di unë, dy zotërinj e një zonjë kishte Lezha. Zotni Hamza Rama, farmacist, i bekuar në këtë emërim, dashamirës me këdo. Brenda 24 orëve e gjithë hjetën gati. I miri i kohrave, Hamza! Zotni Imer Dashi, shitës në dyqanin "Lëndën ndërtimi". Sa e sa blerës u larguan me duar e zezmër plot, për t'u rikthyer tek Imeri i tyre. Atë natë vonë që u kthye porosia, na priste tavolina e shtruar në shtëpinë e Sadikut. U përshëndet me nusen, kjo si dhuratë e natyrës për të. Mësim i çmuar për mua mikpritja e tyre. Një urtësi që zotëron pa u lavdëruar, si frut i përpjekjeve në çift për të krijuar familje, për të lindur atë fëmijë, që si në ëndërr, djali i ktheu puthjen babait. I buzëqeshi nënës në të cilën e bukur qe gjithçka: mendimet, shpirti, veshja, trupi e fytyra. Ndoshta këto cilësi e titulluan zonjë. Sadiku një jetë punë të pasur, të pastër, që vazhdon të "gjuajë"





me sy të ngrohtë, pa mundur kush t'ia idhnojë buzëqeshjen, që e pat rritur e ushqyer me mjaltin e dashurisë shpirtërore. Themi e pat se Sadiku e

pe, në mendje kokë nudo në "puthje" që vret nën zgërdhimje të të çthurura. Një jetë e huaj ky vit brenda jetës sonë. Një shtatzani nate që në mëngjes pjell dreqër.



Besimi, babai i Bashkimit, s'patën dy jetë. Një amanet i Besim Salës:-Varrimi në Lugjaj. Amaneti si dashuri e dikujt rritet

Dhimbja që fshehur nga gjysëmtmerri i bandave në koka të dehura boshe, që patën vënë dhe rrugën e "Dibrës" nën



grumbulluar lotin... I nënës së Bashkimit, Qamiles, i motrës Mynyre, i motrës Ilvije me burrin Dashamir, i Vjollcës (motrës amanet) me burrin Bajazit, i Antonelës, nuse djali, i të afërmve që shoqëronin furgonat. Iu duhet ta ndalin lotin, duke mos iu dorëzuar vetes, si domethënie e pasur malësore. Atë që nuk e bënë dot këta..., sikur e shpërfillën nëpërgjunjtë e maleve nga kalonte kortezhi. E malet sikur

to për të mos u kthyer më kurrë, si i drejti që nuk përkundet. Ëndërrat e Bashkimit në të vërtetë e të tjera, s'gjejnë qetësi që atë ditë që la prapa asgjënë, duke marrë me vete veten, shtatore fëmije, i mbështjellë në rreze dielli e dritë hëne mbi zvarritje këmbësh që e shkulin nga vendlindja, nga Shqipëria nënë, fisnikja e trishtuar, nënë shpërqëndrime kohësh. Kurrë, asnjëherë s'është vonë, por



ditë për ditë e pak nga pak. Por ...97. Kohë që dikush dikton... Të tjerë lëshojnë

plumba, që e tmerroi ikja jonë memece. Sa shumë qe lodhur syri për të



ulnin kokën para dibranit Besim, sikur të dinin mirë se kalon për herë të fundit ndër

asnjëherë s'është herët për t'u rilindur. Edhe sot pas 19 vitesh, ai s'gjen qetësi



## ILUZIONI I MITIT DHE REALITETI HISTORIK

Ndoshta nuk do ta shkruaja fare këtë artikull sikur kundërshtimet ndaj librit "Skëndërbeu" të Oliver Jens Schmitt të mos ishin aq të shumta dhe të parapragjykuara, dhe mua të mos më pëlqente të qëndroja në iluzionin e neutralitetit. Sigurisht që studimi dhe trajtimi i figurave historike, sidomos atyre shumëplanëshe, është i vështirë dhe krijon ndjeshmëri të lartë. Aq më tepër kur ndjenjave të kuptueshme të krenarisë kombëtare u shtohen ato të nacionalizmit provincial, apo keqpërdorimit ideologjik. Kësaj nuk mund t'i shpëtonte figura poliedrike e Gjergj Kastriotit. Çdo vepër historike ka risitë e saj dhe debatet që e shoqërojnë. Vepra e O.J. Schmitt ka sjellë një trajtim krejtësisht shkencor, të ri dhe të paanshëm të Gjergj Kastriotit, ka trajtuar probleme të njohura dhe sigurisht do të shkaktonte dhe diskutime. Të shpjegosh një ngjarje historike apo të shqyrtosh një figurë të tillë si Gjergj Kastrioti do të thotë të bësh një zbërthim analitik, argumentim teorik dhe nxjerrje të konkluzioneve përkatëse. Por çuditërisht debatet mbi librin e O.J. Schmitt në pjesën më të madhe nuk ngrihen mbi baza historike apo argumentime shkencore, por mbi disa pika që për disa janë të diskutueshme, ndërsa për të tjerë "blasfemi". Fjala bie, kjo filozofi e pastrehë ngrihet për çështje si: Cili ishte emri i të atit të Gjergj Kastriotit, Gjon apo Ivan? Cila ishte arsyeja e kryengritjes së tij kundër osmanëve, etj. Në çështjen e parë, sigurisht që kemi të bëjmë me të njëjtin emër, por meqë jemi në këtë pjesë të Europës problemet bëhen serioze pa qënë fare të tilla. Treva nga ishin Kastriotët (duke besuar se ata janë nga Dibra) kishte popullsi shqiptare të besimit ortodoks, deri vonë në zonën e Rekës. Në periferi të kësaj popullsie shqiptare kishte grupe të popullsisë sllave, sidomos bullgare. Kjo popullsi shqiptare për vetë rrethanat historike, fetare dhe sociale të kohës (nuk është rasti t'i analizojmë këtu) kishte ndikime sllave në emrat, vendet, apo terminologjinë kishtarë. Kështu që në mënyrë të zakonshme emrin Gjon në regjistrat kishtarë apo në dokumentat e tjerë do ta gjeje Ivan, ashtu si dhe Johan në shqiptarët ortodoks të jugut. Pjesërisht për të njëjtat arsye dhe në shqiptarët katolikë të veriut të Shqipërisë ndeshesh me emra si Deçko, Ivan, Gojko etj. Askush nuk ka pse trembet, pse historiani O.J. Schmitt përdor formën Ivan ashtu siç ai e ka ndeshur në shumë dokumente. Vetë autori e sqaron pse mendon se në atë mjedis të krishterë ortodoks emri i tij ka qënë Ivan. Pra emri Ivan e bën sllav të atin, aq sa emri Iskander e bën turk të birin. Një moment tjetër shumë i diskutuar është arsyeja për të cilën Gjergj Kastrioti filloi luftën kundër osmanëve. O.J. Schmitt jep të dokumentuar raportin e diplomatëve Sceva de Curte dhe Jacobo Trivulzio drejtuar dukës Francesco Sforza në janar 1454, në të cilën, ndër të

tjera thuhet: " Për arsye të urrejtjes personale që ka kundër Turkut, se ky Turk ka vënë t'i vrasin babanë e atij zotit e ky zot ka vënë të vrasin një vëlla të Turkut". Duke u bazuar në këtë dokument, sipas O.J. Schmitt arsyeja pse Gjergj Kastrioti filloi luftën kundër turqve



është hakmarrja personale. Megjithatë ky dokument nuk mbështetet nga burime të tjera, vlera e tij nuk duhet anashkaluar asesi. Shumë arbër në atë kohë besoj se kanë patur arsye të mjaftueshme të luftonin osmanët përveç mbrojtjes së krishtërit dhe atdheut dhe për arsye të hakmarrjes personale. Pa dyshim që çdo vepër historike do të shkaktojë debate. Personalisht mendoj se debati shkencor rreth kësaj veprë duhet të ishte përqendruar në rëndësinë e Kuvendit të Lezhës apo rolin të Gjergj Kastriotit në politikën europiane, dhe jo në çfarë thamë më sipër. Po përse gjithë kjo zemëratë ndaj profesorit të historisë së Universitetit të Vjenës, duke fluruar një moralitet të përbotshëm?! Që nga vepra e humanistit Marin Barleti deri të ngjyrimet romantike të rilindasve, pa harruar fallsifikimin e Biemmit, heroi ynë Gjergj Kastrioti u vesh me një mit të pacënueshëm gati duke e legjendarizuar figurën e tij. Dhe në dekadat e mëvonshme figura e Gjergj Kastriotit vazhdoi të trajtohej në të njëjtën linjë. (Për përdorimin që iu bë figurës së Gjergj Kastriotit gjatë monarkisë dhe gjatë regjimeve fashiste dhe atij komunist shih kapitullin "Kujtimi, harrë, rikujtimi" të librit

"Skëndërbeu" të O.J. Schmitt). Kështu që gradualisht figura e tij u bë aq mitike sa askush dhe sot nuk guxon ta shqyrtojë historikisht ndryshe, se menjëherë do të akuzohet si antikombëtar, intelektual sharlatan e ku e di unë se çfarë. Por miti sado i nevojshëm t'u duket disave, ai nuk mund të dalë mbi figurën reale të dokumentuar historike. Historia nuk ndërtohet e as nuk bazohet mbi mite, por mbi faktet e dokumentuara historike, jo mbi romantizmin, por mbi logjikën e ftohtë të shkencës. Ka një dallim të qartë midis shpjegimit shkencor të historisë dhe interpretimit ideologjik të saj. Mitet mund t'u vlejnjë njerëzve që nuk kanë ndonjë interes për historinë, nacionalistëve provincialë dhe fëmijëve, por historianëve, studiuesve, studentëve, atyre që u intereson shkenca e historisë, u duhet paraqitur historia objektive, e vërtetë, e pamituzuar dhe e pamanipluar. Ne e dimë shumë mirë çfarë i ka shkaktuar mitizimi i historisë psikologjisë së fqinjëve tanë veriorë. Një faktor tjetër i sulmit që i bëhet O.J. Schmitt dhe veprës së tij, (shpesh duke e ironizuar se si një gjerman, në fakt është zvicerian, mund të bëjë historinë e Shqipërisë, duke harruar se janë pikërisht "gjermanët" dhe të tjerë që dolën nga shkollat gjermane, që vunë themelet e albanologjisë), është mendësia dhe mentaliteti oriental që ndeshet jo rrallë në shoqërinë shqiptare. Me shprehje të tilla si "Skëndërbeu nuk preket" ata nuk lejojnë asnjë lloj analize, diskutimi dhe shqyrtimi as shkencor, as historik dhe as kulturor. Për një orientim është e pamendueshme që një figurë historike, religjioze, kulturore apo politike t'i nënshtrohet dyshimit apo metodës hulumtuese. Kjo ndryshon katërcipërisht nga mendësia oksidentale, pra perëndimore që për karakteristikë të saj kryesore ka aftësinë për analizë kritike të vetvetes, shoqërisë dhe historisë. Mjaft

mirë këtë ndryshim e ka vëzhguar Arbër Xhaferri- "Në shoqëritë ku nuk kultivohet aftësia për introspektion, për vlerësim të bazuar mbi dyshimin, aty ku nuk ka ndryshim të ideve, aty nuk ka histori, por kronikë që përshkruan bëmat e njerëzve të ndryshëm, veprat e të cilëve mitizohen pa vlerësim kritik, fare lehtë ndodh që formohen shoqëri statike dhe të paaftha për ripërtëritje. Në shoqëritë perëndimore dyshimi është faktori që destruktivitet, paragjykimet dhe krijon mundësi për verifikim të pohimeve të ndryshme... dhe tejkalim të ngecjeve që pengojnë zgjerimin e horizontit të djesh. Kjo dhunti për njohje përmes dyshimit mes të tjerash prodhon fenomenin e historisë si proces ku ndryshojnë idetë, vlerat gjithnjë në favor të zhvillimit të bazuar në shkencë". Epërsia e perëndimorëve, ndaj orientaleve qëndron tek aftësia e tyre, e fituar me edukim e dhënies së arsyeve për atë që besojnë, e ndjekjes së mendimit konsequent dhe praktik. Arsyeja në edukim e ka bërë Europën Europë. Në shoqëritë apo në individët me mendësi orientale motoja e iluministëve "Nuk jam dakort me mendimin tënd, por do të luftoj deri në vdekje që ti ta shprehësh lirshëm atë" nuk ka vend. Një arsye tjetër pse sulmohet O.J. Schmitt dhe libri i tij është bash ajo që thotë Volteri "Kur dhe populli përzihet me arsyetimin, gjithçka e ka marrë lum". Njerëzit, duke qënë të doktrinuara me një opinion të caktuar, i japin të drejtë vetes të kundërshtojnë madje dhe historianë e profesorë. Dikush e mban fort një opinion sepse mendon sikur ka mbërritur vetë tek ai, një tjetër sepse e ka mësuar diku dhe është krenar për këtë dhe nuk e ndryshojnë mendimin për shkak të kryelartësisë. Kush e ka lexuar veprën e O.J. Schmitt e ka mjaft të qartë se qëllimi i autorit ka qënë të japë një histori të dokumentuar, të paanshme të Gjergj Kastriotit. O.J. Schmitt ka dhënë një vepër krejtësisht shkencore larg çdo ngjyrimi romantik apo nacionalist, duke shfrytëzuar dokumente të arkivave të ndryshme. Autori nuk ka pasur aspak si qëllim të denigrojë figurën apo të mohojë rolin e heroit tonë në luftën dhe qëndresën e pashoq të tij, as të jetë pjesë e ndonjë komploti sllavo-greko-ortodoks si mendojnë me imbecilitet disa. Pak vetë kanë debatuar mbi veprën e O.J. Schmitt në mënyrë shkencore dhe objektive, pjesa më e madhe e kanë dhënë gjykimin e tyre ose pa e lexuar fare librin, ose e kanë dhënë mendimin e tyre për shkak të një subjektivizmi të rënduar ideologjik. O.J. Schmitt me veprën e tij "Skëndërbeu" si dhe me "Arbërinë Venedike" i ka bërë një shërbim të mirë historiografisë shqiptare. Personalisht mendoj se vepra e tij duhet vlerësuar... por siç thonin latinët "Quot capita, tot sensus"- "Sa krena, aq mendime".


## LEKSHTIA

## NJË BURRË NË VETULL TË TRANGËS

Mark Blach në librin e tij "Mjeshtëria e historianit," shpreh: "...e kaluara është një e dhënë të cilën s'mund ta ndryshojë asgjë.." Kjo sentencë më ka motivuar ta shikoj librin e ri të autorit Gjet Doda "Preng Gjok Deda –monografi-", jo vetëm në këndvështrimin letrar, që pa dyshim ka vlera artistike, por më së shumti në cilësinë studimore. Është një prurje e vlefshme në etnografi, histori dhe lëvizje politike të ndodhura kryesisht në Mirditë, në qindvjeçarim e fundit të mijëvjeçarit të dytë. Gjet Doda filloi të komunikojë me lexuesin së pari, në gazetari në vitet '90 e kënde, me shkrime të ndryshme, për të ardhur në librin e parë "Përtej Kryqëzimit" e në vazhdim "Rrëfej për nënën time", për të ardhur me shumë sukses tek libri "Shënimet e Mija". Botimi që kemi në dorë është libri i tij i katërt. Është një punë serioze dhe një angazhim prej studiuesi dhe letrari. Libri është mirëfilli *Monografi*, por autori ka ditur të ndërthuri jetën e një malësoi tipik, Preng Gjok Deda, që mbart në genin e tij: .. etnosin, mitin, legjendën dhe historinë e trevës ku është lindur, kultivuar dhe ka vepruar. Personazhi është nga katundi Bardhaj (Bozhiq), një katund i vendosur në vetullën e shkëmbit shumë shekullor të quajtur Tranga e Selitës, me vështrim në drejtim të Malit të Skënderbeut dhe të Bregut të Detit. Peisazhi që ka sjellë autori si edhe të dhënat etnokulturore janë të mjaftueshme për të besuar formimin e karakterit të Preng Gjok Dedës. Në këtë parathënie më së shumti do të përqendrohem tek struktura ndërtimore dhe tek shtyllat mbi të cilat autori është mbështetur për të na dhënë këtë botim dinjitoz. Prejardhja e Selitës e Kthellës dhe e Rrënxës, si bajraqe vëllezër, është trajtuar me kujdes dhe në mënyrë bindëse, gjithashtu fiset e Bardhajve, prej nga shkëputen Margjinajt, nga ku merret personazhi kryesor i veprës, burri më në zë i zonës, paraqitet në mënyrë bindëse. Mrekullohesh me mënyrën se si është plazmuar artistikisht karakteri i Preng Gjok Dedës (i Margjin), i mbështetur fort në katër shtylla kryesore: *Puna, Bujaria, Besa, Trimëria*, prej ku personazhi fillon e rritet nëpërmjet

të ngjarjeve që autori i paraqet me mjeshtëri. Personazhin e shohim në dasma, në morte, në rreshtin e krushqve shumë herë i pari, në kullën e tij duke pritur e përcjellë miq, të njohur e të pa njohur, duke dhënë borxhe e duke hyrë dorëzënë, duke ra në gjak e duke marrë gjak, duke dhënë besë e duke e kërkuar atë, duke respektuar njëllor, si të fortin ashtu edhe të dobëtin; si të pasurin, si edhe të varfrin. Ishte i kursyer në fjalë, por i vendosur dhe i shpejtë në të vepruar, qoftë në fjalë a në pushkë. Në pamje të përgjithshme ky është personazhi ynë, por autori në libër është shumë i duruar, duke mos harruar asnjë detaj nga jeta e tij e gjatë – shekullore. Autori, si njohës i mirë i kanunit dhe i historisë, qëndron fort tek besa, nderi dhe mikpritja, që në thelb të gjitha e kanë trimërinë si element të për bashkët. Kulla e vjetër trepodëshe (katëshe), me qoshe, dera e çemeri i saj të skalitura mjeshtërisht, me shesheme e frenxhi në dy katet e sipërme, të ndërtaura për jetesë e qëndresë, të gjitha këto ngajnë më tepër me një kështjellë të fortifikuar, por që kryen edhe funksionin e banimit. Zoti i kësaj kulle, Preng Gjok Deda, ndonëse i pa shkolluar (për arsye që dihen), është i kultivuar dhe i mbrujtur me të gjitha vlerat që i lypen një burri në malësi: për të prirë një lagje krushq, për të pritur e për të përcjellë miq e shokë, për të drejtuar dhe ndarë një pleqëri, për të dhënë e për të mbajtur besën, për të deklaruar fjalën e drejtë pa iu dridhur syri, për të qitë pushkë kur e shikon të nevojshme dhe brenda kanunit, pa iu dridhur gishtit, për të ndarë me mikun a shoqin të mirën dhe të keqen. Besa, nderi dhe fjala e dhënë janë kulte shumë të respektuara ndër shqiptarë e sidomos në krahinën e veriut. Ato përbënin themelin e

marrëdhënieve shoqërore në malësitë tona. Lidhja me fjalë (besë), përbënte kanunin, autoritetin më të lartë e moszbatimi i tij përbënte shkak për dënim. Kjo zbatohet që nga marrëdhëniet në gjini, fis, katund, famulli, bajrak e në nivele më të larta të bashkësisë etnike. Besa është testamenti moral i shqiptarëve që nga periudha mitologjike e kënde. Dy baladat më të famshme tonat, ajo e "Rozafës" dhe "Besa e Kostandinit" lidhen me mbajtjen e fjalës, me mbajtjen e besës. Në shumë kombësi të tjera, *Besa*, nuk trajtohet si në vendin tonë. Tek Sllavët e Jugut përkthehet: "Virtyti themelor i shqiptarëve, trashëguar nga të parët." E trajtova këtë fenomen kanunor mbasi në këtë libër monografik, besa dhe elementë të tjerë kanunor veshin personazhin kryesor. E trajtova pak si gjatë këtë element të kanunit, pasi autori ka paraqitur shumë ngjarje që lidhen me besën dhe nderin e burrit, dhe Preng Gjok Deda ishte dhe mbeti deri në vdekje shumë i lidhur me to. Në ato treva ku rregullat kanunore kanë pasur rol të dorës së parë, formësimi i karaktereve ka dominuar në marrëdhënien me të uriturin, raporti me hasmin, raporti me mikun si edhe prona e përdorimi i saj. Tregohet se një ditë Preng Gjoka me të shoqen nisen për tek një miku i tij. Në udhëtim, në oborrin e një shtëpie, sheh një fëmijë të shtrirë përtokë. Dredhon rrugë, futet në oborr dhe pyet nënën e fëmijës: -Çka ka djali? -Prej uni..., - i përgjigjet e ama me lot në sy.. Prenga menjëherë kthehet në shtëpi, merr bukë e një shtambë me kos, qëndron aty deri sa djali, duke ngrënë, e merr veten. Nëna e djalit e kish uruar: "*Ta bafte Zoti hisen e madhe!*.." – ndërkohë mësohet se djali ishte i hasmit...



Lexuesi do të gjejë në libër episode të tjera të kësaj natyre, në të cilat janë linçuar biseda apo marrëdhënie ndërmjet personash duke pasur hasmëri në mes tyre, por që asnjëherë nuk kanë arritur të tejkalojnë "kodin e mirësjelljes" (të pa shkruar), që ka qarkulluar në malësitë tona. Këtë e bëjnë ata burra trima, që kanë të mbrujtur në shpirtin e tyre edhe ndjenjën e hakmarrjes, por edhe atë të mirësisë, të ndihmës ndaj nevojtarit, të burrërisë përpara një burri. Këtu e ka burimin ajo shprehja e njohur: "*O Zot, më përpiq me hasëm të fortë e mos të koritem.*" Ngjarje të kësaj natyre lexuesi do t'i gjejë të pasqyruara me vërtetësi nga autori, i cili, duke pasur njohje personale me personazhin kryesor dhe me familjen e tij, ka sjellë si rrjedhim përshkrimin real dhe ndjesinë e duhur për këtë vepër të bukur dhe të saktë. Bashkë me mëkësimin e fëmijës, nëna mirditore i ka kënduar djalit, duke e përkundur në djep, me fjalët: "Rritu bir të pastë nana, / Rritu trim ndër kapidana... / Nëpër fusha me flut'ruet, / Nëpër male me luftue / Të do trim ty e lumja nanë... / Hak pa marrë ti s'ke me lanë." / Siç vihet re, edukimi, kultivimi dhe mbështetja në traditë fillon që në djep. Përngjasojnë me nënat spartane që i kalitnin fëmijët e tyre për të qenë të fortë në mbrojtje të Spartës. Shkruesi i këtyre radhëve ka njohje dhe prejardhje fisnore me autorin Gjet Doda, por njëherësh edhe ka punuar për një kohë të gjatë në miniera me nipat e Preng Gjok Dedës. Kjo më solli detyrimin moral e tradicional për të shprehur mendimet e mia në përcjellje të këtij libri, duke iu shmangur klisheve, siç i është shmangur edhe autori, duke qenë i drejtpërdrejtë. Mendoj se kjo vepër, jo vetëm është e fisshme, e shtrirë në kohë dhe në ngjarje, por edhe e arrirë artistikisht, me peizazhe të bukura e dialogje brilante, me një gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme nga të gjithë, ku spikat përshkrimi dhe fjalori i pasur. Le të shërbejë ky libër si *Letër Njoftimi* për Preng Gjok Dedën, si moral për të gjallët, objekt për historianët e substancë për studiuesit. "Moralit i të vdekurit me të gjallin është tradita.." (Niçe).

## U NDA NGA JETA NJË BURRË NË SELITË



Me respekt të thellë e sy të përbotur, shumë njerëz të të gjitha moshave e nga të gjitha krahinat i dhanë lamtumirën e fundit Burrit të njohur më tej se në Selitë, Frrok Prengë Pergjoni. Lindi 90 vjet më parë në një familje me tradita në Lekundë. Që në rininë e tij të hershme, tek djaloshi 13-14 vjeçar u shfaqen dhunti të veçanta, përpos cilësive fizike që vet Zoti i kishte falë. Spikati dukshëm intiligjenca e tij, kur asokohe, në gjithë Seliten, dy persona dinin shkrim e kendim. Në ato rrethana të errësirës pa mbarim, natë dimri pa hënë, kreu shkollën fillore si rrallëkush me përfundime të shkëlqyera. Si i tillë, fill pas çlirimit, ai u reshtue në armaten e mësuesve mirditorë, që me tebeshir në rrasa prej guri, modeluar për herë të parë grafiket kapital të shkronjave shqipe. Është i mirënjohur në krahinë kontributi

i tij vullnetar për zhdukjen e analfabetizmit, plagë ajo sa edhe varfëria. -63 vjet më parë, i mallëngjyer e krenar, -tregon ish nxënësi i tij, Mhill Nikolli, kujtoj doren e tij të ngrohtë duke drejtuar penen në dorën time të dridhshme, sikur ndjej edhe sot zanin e tij të amël e kumbues tek na këshillonte për mësimin dhe edukatën. Dhe, po i emocionuar, do të rrefente ..., vlerësime këto për një individualitet që s'i takon vetem vetes. Ende i ri, por disi më i pjekur në moshë, populli donte ta mandatonte drejtues të pushtetit në katund, ku e justifikoi me përkushtim e ndershmëri besimin që i dha ai. Ka punuar edhe si drejtues në ndërmarrje shtetërore e kooperative bujqësore, ku përherë ka shkëlqyer me shembullin e vet në krye të punëve, duke fituar kështu respektin e të gjithëve. Teksa po kthehesha nga

ceremonia e varrimit të tij, rastësisht takova një mikun tim, Gjergj Deda nga Lajthiza e Oroshit. Me qenë se ai kishte haber për ngjarjen, në bisedë e siper, ndër të tjera veçoi: -E kam njoft shumë vjet më përpara Frrok Pergjonin. Burrë me karakter ka qenë ai. I ndriste puna, i fliste mendja e i peshonte fjala. Vitet do t'i zbardhonin kryet e do t'i vizonin ballin, por gjithsesi vital mbeti Lalë Frroku gjersa mbylli sytë për të fundit herë për të pushuar i qetë përjetësisht te shokët e vëllezërit, etrit e gjyshrit e vet. Në çdo bisedë ku ishte i pranishëm, asnjëherë s'inte pa artikuluar dy fjalë: Punën dhe shkollën. Megjithëse me shikim të kufizuar nga moshja dhe nga sëmundja, s'reshti së lexuari. Vinte shpesh në shkollë, ku zhvillonim veprimtari të ndryshme, ku prania e tij krijonte mjaft afeksione edukative. Në shumë zgjedhje, edhe në vitet e fundit të jetës, qendrimet e tij do të ishin referenca e zgjidhje, pasi kishte logjikë të kthjellët e kurajo të veçantë për të parë të vërtetën në sy e folur gjithnjë në emer të saj. Fundvitet epokale të shekullit që lamë pas, çliruan shpirtin e tij të burgosur për afro gjysmë shekulli. I priti ato ndryshime si shkëlqimin e diellit ditë gushti në humnerë pa fund. "Erdha të votoj noshta për herë të fundit me ju, se s'jam fort mirë me shnet. Gjujt s'më bajnë, por asniherë s'më janë dridh tu hec përpara." Ky paska qenë mesazhi i fundit vetëm katër ditë para se të ulej për të mos u ngritur më nga shtrati i vdekjes. Gjithë jetën e vet, ai e perculli me dinjitet bashkë me shokun e jetës, Dilen. Femër e bashkëshorte ideale, bijë nga një familje sojnikë po në Selitë, edukatore e nënë fisnike me të cilën rriten dhe edukuan gjashtë djem e shumë nipa dhe mbesa. Ata përjetuan humbjen para kohe të djalit të madh, në krahë të të cilëve dha frymën e fundit, dhimbje, që e kapërdinë me krenari spartane, që copton dhe gurin. Rastësi qe kur do të

takoheshim pas shumë kohe, mjaft të emocionuar, ashtu siç edhe u ndamë për të fundit herë, vetëm më pak se një muaj nga kur do të ndrronte jetë. U çmallem si babë e djalë. Biseduam gjatë për jetën, punët e hallet e saj. "Kush ka le do ta provojë, -tha gjatë bisedës, -se jeta asht ene luftë. Ne luftë hyhet me fitue, por kush s'pranon humjen s'njef jeten se s'çohet gjashtë herë kur asht rrëzue pesë. Dhe pas një pauze të shkurtër vazhdoi. Erdha t'i shof ni herë të gjithë fëmijtë e Nkollit, Pashkun, Leken e Vlashin, se pale...!" Nga qendrimet e bisedat, me të cilat artikulonte, ndjeje se priste fundin pa pishman, por më pranë se kurrë ashtu s'ç erdhi. -T'kam sjellë këtë liber (GJIN MARKU dhe LUFTA), o Lalë Frroku që ta lexosh, -folta duke e shtrirë atë drejt tij, si për të prerë rrjedhen e bisedës. Pa më vështruar, tretur se ku në mendime, duke shtrënguar librin me dy duart, theu heshtjen me një shprehje ku lexohej dukshëm shumë mirënjohja për këtë gjest pak simbolik: -Unë s'shof ma me lexue, por po ta fal e sa herë t'i hapish kapakun, më kujto se kushedi ..., -ndërpreu bisedën duke lëshuar një ofshamë sikur të shkulte një pjesë nga qenia e vet. Pa masë u mallëngjeva, vërtetë u drithërova gjer në dhimbje. Disa çaste qendruam në heshtje duke u vështruar në sy, sikur diçka tjetër lamë pa i thënë njëri-tjetrit. Teksa po largohesha pas më shumë se tri orë, më ngjau se më parë u ndava se u takova me të. Paska qenë fatlum për mua rasti, me që do të ishte ndarja e fundit. Gjatë do ta ruaj, me mall në kujtesë atë takim të papërsëritshëm! Frrok.Pergjoni la pas djem, shumë nipa e mbesa, shumë miq e shokë, duke iu dhuruar krenarinë e jetës gati shekullore. Mori me vete respektin e të gjithëve, që as dheu s'do ta shuajë! Lamtumirë!

**PASHK MARK LIKA  
BASHKËFSHATAR**

**“KËNGA E NËNËS”**  
-Poemë nga dom Bardhec Zymi-

Dom Bardhec Zymi, prej Ranocit të Klines (Kosovë), me studimet e larta filozofike dhe teologjike të kryera në Romë, i saposhuguruar meshtar në Mirditë (nga e ka dhe origjinën e të parëve të tij), natyrshëm do të vinte tek levrimi i poemes, pas sprovave dhjetëvjeçare me poezinë e shkurtër, siç e dëshmojnë dy librat e tij të mëparshëm poetike: *“Kush m’i hap portat”(1998)* dhe *“Rilindje”(2006)*. Zymi shfaqet si një poet i veçantë i fjalës së mençur plot ndjesi poetike, poet i misterit të jetës, dashurisë. Poema *“Kënga e Nënës”* ka qenë një ndërmarrje e guximshme e tija, por falë talentit krijues, hulumtimit në lëndën e mbarështruar dhe përkushtimit prej misionari ia ka arritur të poetizojë dashurinë hyjnore të ndërlidhur me atë tokësore. Zoja e bekuar “me pavdekësinë e birit të saj brenda ditëve tona të vdekura” apo të vdekshme, si një Nënë e Madhërishe, e papërsëritshme na bëzan prej dy mijë vjetesh: *“Ja ku jam”*. Është një thirrje epokale, e brishtë dhe e lartë, e sigurtë dhe unike. “Ja ku jam”, për Ty, Biri im, për gjithë ju gjindjen që do të vini në shekuj dhe do ta dini se si u ngjiz, mori frymë, rroi, predikoi, vdiq dhe u ringjall Jezusi, Shpëtimtari i botës. Poeti, me petkun e shenjtë priftëror, ndonëse i ri në moshë, në hapat e parë të meshtarisë dhe të artit të poezisë, e ka sendertuar artistikisht atë histori që shtegton mijevjeçarëve mbi ngjarjen nga e cila zuri fill epoka e re, e thënë atëhere e mbrapa: *pas Krishtit*. Poema *“Kënga e Nënës”* është teologjike, por dhe filozofike, me vokacionin e “Nënës” që rrëfen, mediton, filozofon, kumton për Birin, Krijuesin, botën, mbarë njerëzimin. Zgjedhja që ka bërë autori duke vendosur gjithçka në ligjërimin e saj, ka shmangur mjeshtërisht epicitetin e panevojshëm, teksa ka shtuar lirizmin filozofik, butësinë dhe fisnikërinë e figurës së Zojës.

Ajo është e dashur si çdo nënë për fëmijën e saj, por dhe një tjetër Nënë, sepse ajo është e ndërgjegjshme se po lind një

fillim të ri njerëzor.” Zoja e bekuar e paraqet me nota të rralla lirike krijesen e vet, sipas vështrimit të poetit Zymi: *“Një Zot njeri i*

mendime dhe përtutytime të madhërishe për kohra të largëta apostolike, ndjesi që njeriu i ndjen brenda vetes si atëhere dhe sot. Nga kënga e parë në këngën e shtatë, lexuesi shtegton bashkë me poetin, duke dëgjuar zërin e së Papërllyemes dhe duke marrë mesazhe të pafundme mirësie, dashurie dhe humanizmi. Poema himnizon atë sakrificë të pashembullt që ndodhi vetëm njëherë mbi faqe të dheut, kryqëzim-vdekjen dhe ringjalljen e Jesu Krishtit për të mbërritur apostullimin. Simboli i tij i predkut dhe i shpëtimit do të bëhej kryqi, gjegjësisht shenjzimi i kryqëzimit të tij. Kjo për shkakun se ajo që kishte ndodhur me vetë atë, Birin e Hyut, të mos ngjante me të vdekshmit. Zoja-Nënë ndjek hap pas hapi fatin e Birit të vet, që e quan *“krenaria dhe lulja ime”*, e pranon Krishtin ashtu siç është, flet me Hyun, duke pranuar me adhurim vullnesën e tij për gjithçka ka ndodhur, po ndodh e do të ndodhë me të. E sheh tek rritet i madh, i vetëdijshëm, i vendosur për misionin e shenjtë, teksa 12-vjeçar ai fillon predikimet. E rëndësishme do të ishte se “jetoj vdekja e tij”: *“u ngrite mbi pragun e botës / dhe u bëre këngë / ngase ringjallja në qiell u bë fitore”*. Kënga e shtatë dhe e fundit e kësaj poeme është gjithë frymëzim, ndër modelet poetike teologjike, si një kushtim dhe i Krishtit ndaj Zojës, *“e vogël dhe e madhja Nënë”*, që për të gjithë përvujtërit e saj, ftohet prej Birit në krah të tij, kur ai ngjitet në Altarin e Shenjtë. Pena e poetit të ri, Dom Bardhec Zymi, është sërish e ngulur mbi leter. Qoftë e bardhë ardhja e tij në poezinë e sotme dhe në raven e përndritur të meshtarisë shqiptare, që në Kosovë ka një traditë të vyer historike dhe një elitë të sotme shembull, që i kryen me aq dinjitet punët e fesë dhe të kombit tonë.

**DOM BARDHEC ZYMI**  
**KËNGA E NËNËS**



*Poemë (2006)*

krijesë tej virgjinitetit të saj, madje ajo ka frikë për atë që do të ndodhë në trupin e saj, a do të mundet ta përmbushë vullnetin e të Atit. Vetë protagonistja na i thotë të gjitha, si e kaperceu frikën, si krijesa e gjakut të saj nisi jetën tokësore, duke qenë mishërimi i dashurisë hyjnore për njerëzit. Ajo e di se çfarë do të ndodhë me Jezusin, se pas kalvarit të madh, Ai do të kryqëzohej e njëherësh do të ringjallej. Ajo kishte lindur një bir shenjt mbi shenjtërit, që bashkë me apostujt e tij do të krijonte kishën e vet në të gjithë rruzullin. Njerëzimi kishte nevojë për lutjen dhe shpëtimin, për “një

zhytun / në prehrin tim / të humbur në ujë e Nënave për të marrë frymë / në frymëmarrjen time.” Ajo është e mbushur me shpresën e jetës, që i buron pikërisht nga Biri që solli në jetë për t’ia falur martirizimit, shenjtërimin, jetën dhe përtejjetës, ndaj s’rresht së thëni atij: *“Të mbulova me hijen time / me forcën e dashurisë sime”*. Kësisoj Zoja është krijimi, dhurimi dhe persosmëria e dashurisë jo vetëm për krijesën e vet të gjakut e të shpirtit, pasi ajo është jo vetëm Nëna e Krishtit, por dhe nëna jonë. “Kënga e Nënës”, një poemë e shkruar me art dhe një gjuhë të zgjedhur origjinale, zgjon



## PËR KATËR VITET ME TY!

**-Kushtuar mësuese sime të dashur, Mirela-**

Katër vite plot jetë, katër vite që nuk kthehen më, por mbeten aty, në zemrat tona, në mendjet tona, në jetën tonë, katër vite që na i kushtove Ti mua e dhjetra të tjerëve (le të mos shkruaj për të tjerët). Sot do të shkruaj për mua ... dhe Ty mësuesja ime e dashur, Mirela. Dikur, para katër vitesh, isha vetëm një vajzë e brishtë, naive dhe e dobët emocionalisht. Atë kohë Ti erdhe në shkollën tonë dhe ishe mësuesja më e re. Por tek Ti nuk ekzistonte vetëm rinia, tek Ti ishte një botë e tërë. Ishte, është dhe do të mbetet. Dua t'i marr gjërat një nga një. Ti u fute në klasë plot çiltërsi, një veti që të karakterizon. Nuk e di nëse të kujtohet, por të gjithë u kthyem nga Ti dhe ndoshta, thellë brenda në zemër unë e dija që Ti do të ishe rruga e hapave tonë drejt dashurisë e respektit. Ti buzëqeshje kur na shikoje e ne, në sytë e Tu shihnim qiellin, detin e pafund. Ti nuk dije të thojë njëherë: "Oh, jam e lodhur!". Dhe pse ne nuk mbanim qetësi. Por Ti jo, Ti kurrë s'na bëre të ndiheshim keq, përkundrazi, kur ishim me Ty, ne ishim e gjithë Bota, i gjithë Universi, gjithçka e pamasë... Dhe kur vinte koha për t'u pyetur, të kujtohet? Unë budallaçka vija ndonjëherë pa mësuar, por nuk kisha frikë nga Ty, se dhe po të më qortoje, prap do më doje si më parë, se Ti nuk mban mëri. Më kujtohen fjalët e Tua, sikur të m'i kishe thënë sot, por për mua nuk ishte nevoja të flisje, mua më mjaftonte vetëm shikimi Juaj që të kuptoja çfarë kishe në mendje. Ti arrite që vajzën e brishtë dhe naive, ta bëje një vajzë të fortë dhe ambicioze. Ti arrite të më shndërroje në atë çka jam sot. Për këtë u desh vetëm vëmendja jote, ajo çka kisha nevojë më shumë, ai shikim i përditshëm, që zgjonte tek unë dita-ditës ndjenjën për të ecur përpara. Me Ty kam ndarë shumë gjëra, dhimbje dhe gëzim, vuajtje dhe lumturi. Ti ndoshta këtë nuk e ke kuptuar, por në se në një moment unë të lëndoja Ty, lëndoja edhe veten time. Ti, me çiltërsinë dhe vullnetin Tënd më mësove se për të dalë në dritë duhet forcë. Duhet forcë të jetosh dhe të ecësh përpara. Unë kam gabuar. Jam e vetëdijshme për këtë, por Ti ishe gjithmonë aty për të më falur, sepse të gabosh është njerëzore dhe kur njeriu fal, i ngjan Krijuesit të vet, Hyut. Pikërisht fjala Jote të bënte Ty hyjnore. Edhe kur isha e mërziur, Ti ishte aty duke më ofruar mbështetje. Madje shpesh më thojë se ishe e gatëshme për të më dëgjuar dhe ndihmuar në çdo lloj problemi. Prandaj ndihesha e mbrojtur nga Ti. Ti ishte si një shtresë oksigjeni që më rrethonte dhe unë merrja frymë lirisht. Dita – ditës unë po rritem, por fëmijëria ime është pjesë e imja dhe aty bën pjesë dhe Ti. Një ditë do më duhet të të them "Mirëupafshim!", por do jetë e vështirë për mua, sepse do më duhet të përshëndetem me atë që s'e ndërroj me asgjë, me Ty, mësuesja ime e dashur, Mirela. Shpresoj ta lexosh këtë leter të botuar në gazetë, me ato ndjenja dhe emocione që e shkruajta unë. Dhe nëse kjo leter nuk botohet, grisat e vjetërohet, dua t'i mbash mend fjalët e nxënësës që të do shumë...!

**AURORA LUSHAJ**

**Klasa IX<sup>C</sup>, Shkolla 9-vjeçare "Gj. Fishta", LEZHË**



Adresa e Redaksisë: Studio "Lissalba", pranë Qendrës Kulturore të Fëmijëve (OKF), përballë Urës së Re.  
Mund të kontaktoni me redaksinë në celular 068 22 78 746 si dhe e-mail: [lissalba@hotmail.com](mailto:lissalba@hotmail.com)